



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 18.11.2019, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Selami Jenishehri, Roland Xhelilaj dhe Eugen Bojaxhiu.

**Mungojnë:**

Klotilda Bushka dhe Almira Xhembulla

**Të ftuar:**

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rudina Degjoni – Drejtoreshë e Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Saimir Kadiu – Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Denada Seferi – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etiola Kola – Këshilltare e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Enver Roshi** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me në rend dite shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Prezente nga kjo ministri kemi zonjën Ogerta Manastirliu, ministre; zonjën Gelardina Prodani, sekretare e Përgjithshme; zonjën Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është?

Gjithashtu, kemi zotin Saimir Kadiu, drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; zonjën Denada Seferi, drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zonjën Etiola Kola, këshilltare e ministres.

Fjala është për ju, zonja Manastirliu.

**Ogerta Manastirliu** – Përshëndetje!

Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë,

Më lejoni të bëj një përmbledhje sintetike të projektbuxhetit të vitit 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Më lejoni të them që në krye të herës se buxheti që vjen për diskutim dhe për miratim në Kuvendin e Shqipërisë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është i orientuar, i hartuar dhe është punuar për të mbështetur qytetarët në funksion të përmirësimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes së grupeve vulnerabël, kategorive në risk dhe qytetarëve me nevoja të veçanta. Ky buxhet është udhëhequr gjatë gjithë procesit të hartimit të tij nga parimet e solidaritetit, të universalitetit, të uljes së barrierave dhe të hendeqeve. Kjo bën që më shumë persona të përfitojnë shërbime shëndetësore, që të ketë më shumë akses në këto shërbime, që këto shërbime të jenë të një cilësie më të lartë dhe, sigurisht, që të ulen shërbimet nga xhepi për shëndetësinë. Nga ana tjetër, në sektorin e mbrojtjes sociale është një buxhet i cili orientohet nga parimet e solidaritetit, të universalitetit dhe të uljes së pabarazive.

Dua të them se buxheti i vitit 2020 konsolidon programet dhe reformat, tashmë të ndërmarra, qoftë për shëndetësinë, qoftë për mbrojtjen sociale. Buxheti parashikohet të jetë në vlerën 77 miliardë e 735 milionë lekë, përfshirë edhe kontributet nga skema e sigurimeve shëndetësore në vlerën 14 miliardë. Në total, ky buxhet (pra për të dy sektorët) është 4,33% i

prodhimit të brendshëm bruto ose 14,61% përkundrejt buxhetit të shtetit. Krahësuar me buxhetin e vitit 2019, ky buxhet është rritur në masën 4% më shumë, ose në vlerë absolute 2 miliardë e 98 milionë lekë.

Dua ta nis me sektorin e mbrojtjes sociale, si një sektor prioritar në funksion të rritjes së mbështetjeve për personat në nevojë, për grupet vulnerabël, për ata më të pamundurit, të cilët meritojnë dhe kanë të drejtë të kenë më shumë mbështetje, një mbështetje të qëndrueshme, por, mbi të gjitha, të kenë alternativa që u sigurojnë atyre më shumë mirëqenie. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se me programet e mbrojtjes sociale për vitin 2020, pra buxheti i vitit 2020 siguron që të futemi në një reformë, e cila do t'i mbështesë më shumë personat me aftësi të kufizuar. Fillojmë që këtë vit, pra që në datën 1 dhjetor të vitit 2019, shtrirjen e reformës për aftësinë e kufizuar, e cila fillon në qarkun e Tiranës, më pas përgjatë viteve 2020-2021 vazhdon në qarqet e Elbasanit dhe Durrësit dhe më tej në të gjithë Shqipërinë. Kjo skemë do të mbështetet nga buxheti i vitit 2020 në vlerën 16,6 miliardë lekë, do të mbështesë më shumë se 166 mijë persona me aftësi ndryshe, duke përfshirë këtu edhe rreth 4500 qytetarë (invalidë pune), të cilët nuk janë përfshirë më parë, por, me ndryshimet që bëme dhe miratuar në ligjin "Për asistencën sociale", ne do të arrijmë të mbështesim edhe ata persona, të cilët nuk kanë pasur dhe nuk kanë paguar një vit, në pesë vjetët e fundit, kontribute të sigurimeve shoqërore. Kjo do të thotë që kjo skemë hapet më shumë për të zgjeruar mbështetjen për kategoritë e riskuara të personave me aftësi ndryshe dhe invalidët e punës.

Nga ana tjetër, është një vlerësim i ri, i cili do të realizohet, por ka në fokus mbështetjen e fëmijëve me aftësi ndryshe. Në fakt, ndryshon edhe masa e mbështetjes së kategorive të fëmijëve nga 0-2 vjeç dhe 2-18 vjeç, duke siguruar që personat apo fëmijët me aftësi ndryshe, sipas kategorizimit që reforma dhe vlerësimi i ri bio-psiko-social përcakton, të mbështeten më shumë. Pra, nga 70% e masës që mbështeteshin deri sot, duke filluar me shtrirjen në Tiranë, do të ketë mbulim 100% të masës së mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar, duke i parë në katër klasifikime (sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve): të kategorisë së rëndë, të thellë, të moderuar dhe të lehtë. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se buxheti i vitit 2020 na jep mundësinë për të mbështetur më shumë fëmijë me aftësi të kufizuar dhe në një masë më të lartë të pagesës për fëmijët me aftësi të kufizuar. Sigurisht, me shtrirjen e reformës, kjo do të jetë pjesë e vlerësimit për të gjitha qarqet. Ndërkohë që reforma fillon, ose vlerësimi i ri (transformimi i skemës me vlerësimin e ri bio-psiko-social), me Tiranën, për t'u shtrirë më pas në Elbasan, në Durrës dhe në të gjitha qarqet e tjera të vendit, nga ana tjetër, kemi programin e ndihmës ekonomike. 4,5 miliardë lekë do të jenë të alokuara në buxhetin e vitit 2020 për mbështetjen e familjeve në nevojë. Sigurisht, ndihma ekonomike, sikurse e kemi thënë, është

një ndihmë e përkohshme që u jepet familjeve. Ndaj, përveç planit tonë strategjik për daljen nga skema e ndihmës ekonomike, tashmë kemi edhe një program aktiv të daljes nga kjo skemë dhe të nxitjes së anëtarëve të familjeve me programe të punësimit dhe ndërmjetësimit. Dua të them që sot skema e ndihmës ekonomike mbështet më shumë ata që kanë më shumë nevojë, ata që janë më shumë në varfëri, sidomos komunitetet e veçanta. Më shumë se 2600 familje që përfitojnë sot nga skema e ndihmës ekonomike janë të komunitetit rom dhe egjiptian. Pra, është një skemë që targeton më mirë varfërinë dhe mbështet më shumë ata që kanë më shumë nevojë, si gratë kryefamiljare, ku më shumë se 6000 gra kryefamiljare mbështeten nga kjo skemë.

Gjithashtu, dua të përmend një fakt të rëndësishëm: kemi qenë bashkë rreth një vit e pak më parë kur kemi prezantuar reformën e skemës së re të ndihmës ekonomike, ku u rritën pagesat; ku u krijua sistemi që verifikonte në mënyrë online dhe shmangte abuzivitetin. Kjo skemë tashmë është konsoliduar dhe jam e kënaqur të them që nga 69 mijë aplikues, 66 mijë janë përfitues, gjë që do të thotë se më shumë se 90% e familjeve që aplikojnë për t'u mbështetur nga programi i ndihmës ekonomike, janë përfitues nga ky program. Por, sigurisht, politika jonë nuk mbetet vetëm në politikën e dhënies apo të ofrimit të pagesave për familjet në kushte të vështira sociale dhe ekonomike, por, mbi të gjitha, është alternimi nëpërmjet programeve të punësimit dhe aftësimit profesional për daljen nga kjo skemë, që është edhe objektivi madhor dhe final i programit të ndihmës ekonomike.

Dua të ndalem te buxheti i vitit 2020 për të thënë se ky është buxhet që mbështet fëmijët, sepse programet që, tashmë, vijnë dhe konsolidohen, siç është programi i bonusit të bebes, i cili u mbështet për herë të parë në vitin 2019, si një program që do të sjellë rritjen e lindshmërisë, sepse është një program që u fut në programet e reja për dy arsye.

E para, si një program pro natalitetit, pra për rritjen dhe nxitjen e lindshmërisë, por, gjithashtu, edhe për të siguruar një start të barabartë të çdo fëmije të porsalindur dhe familjeve të tyre për të pasur dhe për t'u kujdesur ashtu siç duhet për fëmijët, duke siguruar që nëpërmjet bonusit të bebes të kemi një mbështetje direkte nga shteti. Pra, ky është buxheti që u shkon qytetarëve, buxheti që u shkon njerëzve. Janë 20 milionë dollarë, të cilat qoftë nga buxheti i vitit 2019, por edhe nga buxheti i vitit 2020 shkojnë direkt në xhepat e familjeve shqiptare, pra atyre që gëzohen me fëmijën e parë, të dytë dhe të tretë, duke u dhënë bonusin e bebes, këtë shpërblim financiar për fëmijët e porsalindur.

Gjithashtu, në programin e mbrojtjes sociale kemi dy instrumente të reja, që kanë filluar në vitin 2019, por që do të konsolidohen në vitin 2020, që janë dy instrumentet financiare për të ndërtuar shërbime sociale për komunitetet në nevojë, për grupet në nevojë. Është instrumenti i fondit social, i cili në buxhetin e këtij viti do të jetë më shumë se 200 milionë lekë, që u

dedikohet pikërisht bashkive, organizatave jofitimprurëse apo edhe strukturave të tjera të interesuara për të ofruar më shumë shërbime për kategoritë në nevojë, më shumë shërbime për të moshuarit, më shumë shërbime për gratë e dhunuara të trafikuar; më shumë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar; më shumë shërbime për fëmijët e rrugës; më shumë shërbime për nxitjen e arsimimit të grupet në nevojë. Pra, është një program, një instrument që ofron mundësitë për të financuar shërbime sociale aty ku nuk ka shërbime sociale për grupe të ndryshme dhe kategori të ndryshme përfituesish; një instrument i cili ka filluar në vitin 2019, ku pesë bashki janë përfituese; 19 bashki kanë aplikuar dhe do të jenë përfituese me buxhetin e vitit 2020 për të mundësuar pikërisht krijimin në territor të një sistemi të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, nga i cili të përfitojnë grupet dhe kategoritë në nevojë. Sepse, sigurisht, kanë shumë rëndësi skemat e mbrojtjes sociale, ato të subvencionimit në *cash*, pra nuk flasim vetëm për *cash*-in direkt, që i shkon ndihmës ekonomike, pasi bashkë me ndihmën ekonomike, gjithashtu, jepen subvencionet për energjinë elektrike, për vaksinimin e fëmijës, për mosbraktisjen e shkollës, që janë të gjitha në paketën 4,5 miliardë lekë për këtë program, por gjithashtu, edhe shërbimet në territor. Pra, është për ato që kanë shumë nevojë, si për komunitetet qoftë për shërbime të fizioterapisë apo të logopedisë për fëmijët me aftësi të kufizuar, qoftë për shërbimet sociale e komunitare për të moshuarit, për mensat sociale, që janë aq të nevojshme në qarqe të ndryshme të vendit dhe ku nuk ekzistojnë.

Ne sot kemi instrumentin për të bërë të mundur pikërisht ngritjen e shërbimeve sociale. Ndaj edhe bashkitë, patjetër, që do të vijojnë të nxiten për të aplikuar nga ky fond, sepse ky i fundit, përveçse është një instrument, garanton që financimi të kërkojë edhe kontributin e vetë bashkive, duke i bërë edhe bashkitë shumë më të përgjegjshme për shërbimet sociale në territor, sigurisht, për të mbështetur komunitetet e tyre lokale. Nga ana tjetër, ndërmarrjet sociale janë një tjetër instrument, i cili garanton pikërisht zhvillimin e punësimit të qëndrueshëm, ku tashmë katër organizata jofitimprurëse kanë marrë statusin e ndërmarrjeve sociale. Vitin që vjen buxhetojmë 150 milionë lekë për ndërmarrjet sociale për të garantuar punësimin e qëndrueshëm, duke vendosur kushtin që të punësohen edhe persona, të cilët janë anëtarë të familjeve me ndihmë ekonomike apo gra me probleme social-ekonomike, për të mundësuar pikërisht këtë mbështetje direkte për kategoritë në nevojë për punësimin e tyre të qëndrueshëm.

Për sa i përket shëndetësisë, këtu do të ndalem edhe më gjatë, pavarësisht se do të kemi mundësi për t'i diskutuar edhe në hollësi programet e mbrojtjes sociale që vlerësoj se kanë një impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve, pasi buxheti i vitit 2020 është një buxhet i cili influencon direkt në mbështetjen e grupeve në nevojë, në uljen e pabarazive dhe në mirëqenien e fëmijëve, të moshuarve dhe grave. Buxheti i shëndetësisë është një buxhet, i cili

rritet në masën 48%, krahasuar me buxhetin e vitit 2013. Është një buxhet që e kemi 4% më shumë se në vitin 2019, një buxhet që mbështet aksesin, mbështet cilësinë dhe ul pagesat nga xhepi; një buxhet i cili e drejton vëmendjen te qytetarët, te nevojat e tyre, te pritshmëritë e tyre në sistemin shëndetësor dhe është një buxhet, i cili mbështet edhe politikat e reja brenda sistemit. Pra, nuk vijmë vetëm me paketën e programeve të konsoliduara, por vijmë në vitin 2020 edhe me projekte dhe investime të reja për sistemin shëndetësor, që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e shërbimeve qoftë në shërbimin parësor, qoftë në shërbimin dytësor apo në atë terciar, pra universitar, si dhe në rritjen e aksesit edhe tek treguesit direktë që lidhen me shëndetin e popullatës.

Buxheti i vitit 2020 parashikon 52 miliardë e 675 milionë lekë për shëndetësinë ose 2,99% përkundrejt prodhimit të brendshëm bruto dhe 9,99% përkundrejt buxhetit të shtetit. Pra, afërsisht 10% e buxhetit të shtetit shkon për sektorin e shëndetësisë. Sigurisht, edhe nga pikëpamja krahasuese me vendet e tjera, nuk po i referohem këtu prodhimit të brendshëm bruto, por dedikimi që i shkon buxhetit të shëndetësisë është shumë i pranueshëm dhe brenda standardeve të tjera të rajonit, ku 10% e buxhetit shkon për sektorin e shëndetësisë. Sigurisht, buxhetet për shëndetësinë do të jenë gjithnjë të pamjaftueshme, por ne jo vetëm kemi rritur dy herë buxhetin e shëndetësisë nga viti 2013, por çdo vit e rrisim buxhetin për të optimizuar shërbimet, për të racionalizuar shërbimet, si dhe për të pasur më shumë efikasitet brenda sistemit, duke garantuar edhe politika të reja për kujdesin shëndetësor.

Për sa i përket aspektit të parandalimit dhe shëndetit publik, ne do të garantojmë me buxhetin e vitit 2020 kontrollin mjekësor falas (*check up-in*) për 475 mijë qytetarë të grupmoshës 35 vjeç-70 vjeç. Më lejoni të them këtu se ka pasur një rritje të ndërgjegjësimit të popullatës për të kryer një herë në vit falas kontrollin mjekësor bazë, si një ndër instrumentet më të rëndësishme që sot ka mjeku i familjes në dorë, për të vlerësuar riskun ndaj sëmundjeve kronike dhe është një program nga i cili ne sot po marrim të dhëna, të cilat po na shërbejnë për të ndërtuar programe të qëndrueshme të shëndetësisë.

Pikërisht, referuar kontrollit mjekësor bazë apo edhe politikave për mbështetjen e grupeve të riskuara, ne kemi ngritur gjatë vitit 2019 dhe do të financojmë në vitin 2020 programe që do të vijnë të mbështesin parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm. Ashtu siç në vitin 2019 ndërtuam programin e parandalimit për kancerin e qafës së mitrës, duke ndërtuar programin kombëtar, ne do të vijojmë të mbështesim më shumë se 17 mijë gra me buxhetin e vitit 2020 për të mundësuar realizimin falas në çdo qendër shëndetësore të testit HPV, i cili ndikon drejtpërdrejt në parandalimin e këtij kanceri. Ndërkohë, me mbështetjen dhe investimet që do të kemi në buxhet për vitin 2020 do të mund të kemi për herë të parë një program

kombëtar të depistimit dhe të ekzaminimit të kancerit të gjirit, pra nëpërmjet shërbimeve të mamografeve në spitalet rajonale dhe në disa poliklinika.

Do të kemi mundësi që të garantojmë edhe në vijim mbështetjen e të gjithë sistemit të kujdesit parësor në mbrojtje të popullatës. Do të ndalem më pas tek investimet për të theksuar investimet që do të kemi në shërbimin e kujdesit parësor. Ndërkohë që në aspektin e trajtimit mjekësor do t'u sigurojmë mbi 400 mijë qytetarëve me sëmundje kronike trajtimet falas me alternativat e para të mjekimeve (më shumë se 1150 alternativa mjekimi) nëpërmjet skemës së rimbursimit të barnave, ku këtë vit 11 miliardë lekë do të jenë të destinuara për të mbështetur skemën e rimbursimit të barnave, duke futur këtu, gjithashtu, pajisjet mjekësore dhe mbështetjen që tashmë u kemi dhënë prej dy vjetëve fëmijëve dhe të rinjve me diabet (pra grupmoshën 0-25 vjeç) të mbështetur me fishat falas të diabetit, duke vlerësuar edhe mbështetjen për grupmoshën mbi 65 vjeç brenda vitit 2020. Do të mbështeten më shumë se 64 mijë pacientë për ndërhyrjet operatore me instrumentet e reja dhe të sterilizuara; do të mbështesim më shumë se 10 mijë qytetarë me paketat mjekësore, të cilat, tashmë, janë përfshirë në programet e Ministrisë së Shëndetësisë jo vetëm në sistemin publik, por edhe në atë jopublik, në mënyrë që të garantojmë uljen e radhëve të pritjes, gjë që, në fakt, është bërë tashmë realitet, pasi radhët e pritjes për ekzaminime, sidomos për koronarografite janë ulur 2-3 javë, që janë optimale krahasuar edhe me vendet e tjera shumë më të zhvilluara se ne në shëndetësi. Nga ana tjetër kemi paketa, që do të vijojnë të mbështeten jo vetëm në spitalet universitare, por edhe në spitalet rajonale, siç është paketa e kataraktës, ku më shumë se 2500 të moshuar do të përfitojnë nga lentet falas, tashmë e financuar jo vetëm në QSUT, por edhe në spitalin e Elbasanit, tashmë e shtrirë edhe në spitalin e Durrësit, Vlorës dhe Fierit në vitin 2020. Pra, me buxhetin e vitit 2020 do të kemi mundësi për shtrirjen e shërbimeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kujdesit shëndetësor. Për këtë kategori do të kemi mundësi që me buxhetin e vitit 2020 të përmirësojmë nivelin diagnostik të ndjekjes për sa i përket shërbimit laboratorik, ku do të përmirësohet shërbimi i laboratorëve nëpërmjet PPP-ve me një paketë të plotë të testeve laboratorike, duke dyfishuar numrin e testeve dhe duke garantuar jo vetëm një diagnostikim më të shpejtë dhe efikas, por gjithashtu edhe një trajtim dhe ndjekje shumë më të mirë për pacientët që vuajnë nga problematika të ndryshme shëndetësore. Buxheti do të vijojë të garantojë furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore për spitalet tona për të mos pasur asnjë problematikë, ashtu siç ka qenë në këto vite, ku furnizimi i vazhdueshëm me barna dhe pajisje mjekësore nuk ka munguar dhe kemi pasur një qëndrueshmëri.

Për sa u përket politikave të reja, programeve të reja dhe shërbimeve të reja, të cilat buxheti i vitit 2020 mbështet, kemi 3 momente të rëndësishme: për herë të parë kemi programin

kombëtar për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, që në vitin 2020 e fusim si një paketë të plotë të ofrimit të shërbimit, i cili nuk është vetëm diagnostikim, por edhe kontroll, pasi këtu përfshihet edhe mundësia për ndjekje më të targetuar të grave në shërbimet e onkologjisë dhe në kimioterapitë e rretheve, pasi tashmë është i mundur edhe realizimi i trajtimit 100% me barna të shtrenjtë siç është herceptina, e cila është e garantuar, por edhe me barna të tjera nëpërmjet listës së rimbursueshme dhe përmirësimit të trajtimeve në Spitalin Universitar “Nënë Tereza”. Gjithashtu, ne vijmë me një shërbim të ri në vitin 2020, ku buxheti i vitit 2020 jo vetëm që konsolidon shërbimet ekzistuese, por projektojmë edhe hapjen e shërbimeve të reja, siç është shërbimi i kardiokirurgjisë në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, ku në muajt e parë të vitit 2020 do të kemi hapjen e këtij shërbimi, të cilin e financon pikërisht buxheti i vitit 2020 si një shërbim i ri, që do të ulë radhët e pritjes në një shërbim siç është ai i kardiokirurgjisë. Ju e dini që sot ne kemi vetëm një shërbim unik kardiokirurgjik në QSUT dhe hapim shërbimin e dytë publik, duke ulur kështu edhe kostot, sepse në momentet që kishte radhë të madhe pritjeje dhe kishte emergjenca ne duhet ta paguanim si paketë në spitalin jopublik. Duke e hapur këtë shërbim në spitalin publik, jo vetëm që reduktojmë kostot, por sigurisht krijojmë edhe bazën e mirë të kompeticionit mes shërbimeve publike, duke pasur si fokus zhvillimin e këtyre shërbimeve. Nga ana tjetër, për herë të parë në shërbimin tonë publik kemi një investim të ri për sa i përket një trajtimi, i cili nuk është bërë ndonjëherë në Shqipëri, që është transplantin e palcës së kuqe. Në vitin 2020 ne investojmë për fillimin e këtij shërbimi, pra për transplantin e palcës së kuqe, në shërbimin e hematologjisë në QSUT, duke garantuar që edhe ky proces kaq i rëndësishëm i këtij trajtimi kaq të rëndësishëm, që shumë qytetarëve u duhet të shkojnë jashtë vendit për ta kryer, të mund të kryhet në QSUT. Sigurisht që spitali i ri i sëmundjeve të brendshme do të ketë mundësinë që të ketë edhe ambiente shumë më të mira, siç i ka sot spitali 6-katësh, por ajo që është shumë e rëndësishme është që ne do të investojmë këtë shërbim të ri brenda vitit 2020.

Dua të ndalem tek investimet që do të kemi në infrastrukturën parësore dhe spitalore. Duke thënë se buxheti i vitit 2020 është edhe buxheti më i lartë për sa u përket investimeve në shëndetësi, 30 milionë dollarë do të jenë investimet në shëndetësi, duke garantuar jo vetëm finalizimin e projekteve tashmë të inciuara, por edhe hapjen e projekteve të reja të infrastrukturës parësore e spitalore dhe pajisjeve biomjeksore, kaq të nevojshme, për të siguruar mbarëvajtjen e punës, dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve në spitalet tona. Do të kemi investim në strukturën parësore për 120 qendra shëndetësore dhe ambulanca. Ashtu siç thashë që gjatë vitit 2018 kemi realizuar rehabilitimin e 80 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin, ashtu siç po realizojmë me buxhetin e vitit 2019 rehabilitimin e 100



qendrave shëndetësore, buxheti i vitit 2020 do të mbështesë rehabilitimin e 120 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin. I kemi dhënë një fokus shumë të rëndësishëm ambulancave në zonat rurale për të garantuar akses, kushte më të mira për mjekët dhe infermierët, por mbi të gjitha shërbim më dinjitoz për qytetarët dhe pacientët. Do të vijojmë me investime në poliklinika, pasi nëpërmjet programit të kooperacionit italian kemi përfundimin e një faze të këtij projekti për pajisjet në poliklinikën e Gjirokastrës dhe Peshkopisë. Ne do të vijojmë me investimet në rehabilitimin, ndërtimin dhe jetësimin e rrjetit të materniteteve. E thashë edhe në fillim që fokusi ynë janë fëmijët dhe nënat, nëna të shëndetshme dhe fëmijë të shëndetshëm.

Për sa u përket investimeve që ne kemi bërë në shëndetësi me fokus gruan dhe nënat e reja, ne mund të numërojmë shumë, por ajo çfarë buxheti i vitit 2020 sjell janë 4 maternitete. Këtë vit fillojmë me ndërtimin dhe rehabilitimin e maternitetit “Mbretëresha Geraldinë”, vijojmë investimin për ndërtimin e maternitetit të ri të Lezhës, të Beratit dhe të Kukësit. Ndërkohë që vijojmë të fuqizojmë rrjetin e pediatrive në vend. Kemi filluar në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza projektin për ndërtimin dhe rehabilitimin e spitalit pediatrik, në vlerën 9 milionë euro, dhe ana tjetër me buxhetin e 2020-ës do të vijojmë investimin në spitalin pediatrik të Durrësit dhe furnizimin me pajisje për spitalin pediatrik. Gjithashtu, do të kemi investime për sa u përket pajisjeve, pasi e thamë që programi kombëtar për depistimin dhe kontrollin e kancerit të gjirit kërkon gjithashtu pajisjen e të gjitha spitaleve rajonale me mamografi dhe rinovimin e plotë të pajisjeve për disa shërbime në spitalet rajonale. Ne e kemi thënë që qëllimi ynë është të ofrojmë shërbime shëndetësore afër vendbanimit, sepse njerëzit meritojnë të kenë shërbime aty ku jetojnë, jo të gjithë kanë mundësinë të vijnë në QSUT. QSUT-ja nuk duhet të jetë aq e mbingarkuar sa ka qenë, sepse sot shifrat tregojnë që shumë ndërhyrje operatore, të cilat nuk u bënin në rrethe, sot mund të bëhen, dhe shumë ekzaminime që nuk bëheshin, sot bëhen në spitalet rajonale, por ajo çfarë është e rëndësishme është se nëpërmjet teknologjisë së flotës së re të aparaturave të kemi mundësi të ofrojmë më shumë shërbime. Ndaj, buxheti i 2020-ës ofron mbështetje për sa u përket pajisjeve dhe teknologjisë, të cilat mbështesin mjekët për kryerjen më të mirë të punës së tyre. Gjithashtu, do të shtojmë pajisjet jetëshpëtuese për shërbimin e urgjencës paraspitalore dhe do të kemi mundësinë që këtë vit, me buxhetin e 2020-ës, të mundësojmë financimin për rehabilitimin e Qendrës Kombëtare të Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, e cila ofron shërbime rezidenciale për fëmijët me problematika të ndryshme, si: autizmi, sindroma daun, si dhe problematika që kanë të bëjnë me vështirësi motorike të fëmijëve. Kjo qendër do të jetë gjithashtu fokusi i punës sonë në transformimin e shërbimeve që ajo ofron, në mënyrë që të kemi edhe pole të tjera të

shërbimit në disa rajone të vendit, të cilat të udhëhiqen pikërisht nga kjo qendër, që është një qendër e specializuar dhe kërkon investime.

Dua të ndalem te një nga komponentët e rëndësishëm të këtij buxheti, që është mbështetja për shëndetin mendor, si një ndër komponentët shumë të rëndësishëm që edhe OBSH-ja po i kushton një rëndësi të veçantë. Problematikat e shëndetit mendor duhen referuar në planin e politikave, por edhe në planin e ndërhyrjes me një përgjegjësi maksimale nga shtetet. Shqipëria nuk ngelet prapa, sepse ne sot investojmë më shumë se 12 milionë euro për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor, në trajtimin me shërbime për shëndetin mendor nëpërmjet shtëpive të mbështetura, nëpërmjet qendrave, të cilat trajtojnë këto probleme, por nuk është e mjaftueshme, sepse ne sot na mungon një rrjet, i cili duhet të jetë në komunitet për sa u përket identifikimit të problemeve të shëndetit mendor. Ne sot kemi një program, që është programi i kontrollit shëndetësor bazë, që brenda vlerësimit të tij ka edhe një komponent për shëndetin mendor, por nuk është i mjaftueshëm, pasi ne kemi nevojë që të kemi një rrjet, i cili të na garantojë që problemet e shëndetit mendor të kapen në kohë dhe të trajtohen në kohë. Ndaj, për vitin 2020 do të ketë në çdo qendër shëndetësore, në 413 qendra shëndetësore, një punonjës social dhe psikolog, i cili do të mundësojë pikërisht evidentimin dhe referimin e problematikave që dalin nga kontrolli mjekësor bazë dhe nga rrjeti i mjekëve të familjes dhe infermierëve për t'i referuar më pas për trajtime dhe ndjekje të mëtejshme dhe për të plotësuar një panoramë, e cila sot mungon në strukturën e shëndetësisë për sa i përket problematikave të shëndetit mendor. Është folur shumë për shëndetin mendor, sidomos në ditët kombëtare të shëndetit mendor, por askush nuk e ka vlerësuar. Ne mendojmë edhe për këtë aspekt dhe vlerësojmë që fokusi i punës sonë, përpos të gjitha problematikave të tjera, sigurisht në radhën e sëmundshmërisë shëndeti mendor vjen më pas, por po bëhet një problem alarmant për OBSH-në dhe për vendet e tjera. Sigurisht që të parat vijnë sëmundjet kardiovaskulare dhe sëmundjet tumorale, që ne kemi bërë hapa para për trajtimin e tyre, por shëndeti mendor është një nga ato komponentë të rëndësishëm të sistemit shëndetësor, për të cilin ne vlerësojmë se duhet të kemi një angazhim maksimal. Ndaj, duhet vendosja e këtij rrjeti brenda strukturave të qendrave shëndetësore, sepse qendrat shëndetësore sot kanë nevojë të reformohen. Ne e kemi strategjinë, e cila është në fazën përfundimtare të ngritjes së rrjetit të qendrave socioshëndetësore. Ndaj përfshirja e punonjësit social dhe psikologut brenda strukturave të qendrave shëndetësore do të na japin një garanci më shumë për trajtimin socioshëndetësor dhe të problematikave. Ndërkohë ne po ndërtojmë sistemin e vlerësimit të KMCAP-ve me pagesat e aftësisë së kufizuar, ku brenda qendrave shëndetësore po përfshijmë këto vlerësime edhe si godina, pra nga aspekti fizik i tyre, por kjo nuk mjafton, sepse neve na duhet të ndërtojmë një

sistem, i cili i përgjigjet nevojave të popullatës, merr riskun, por merr edhe trajtimin brenda strukturave të kujdesit parësor. Me këtë qasje dhe me qasjen e ndryshimit që qendrat shëndetësore duhet të pësojnë edhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve demografike, edhe për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshimeve epidemiologjike që kanë ndodhur, në strategjinë për kujdesin parësor kemi vendosur që do të kemi qasje për sa u përket shërbimeve socioshëndetësore. Ky është një hap drejt zhvillimi të shërbimeve socioshëndetësore në vend. 413 qendra shëndetësore do të kenë brenda strukturës së tyre një punonjës social ose një psikolog për të referuar ose për të adresuar këto problematika, duke filluar me shëndetin mendor dhe më pas duke u zgjeruar për të krijuar një bazë më të mirë të sigurimit të strukturave socioshëndetësore.

Në aspektin e mbështetjes së burimeve njerëzore do të vijojë programi i bonusit të mjekëve, 2,5 milionë lekë plus pagën për mjekët, të cilët kërkohen të ofrojnë shërbime jashtë Tiranës. Gjithashtu, programi i patronazhit do të vijojë të mbështetet financiarisht për të siguruar një pagesë ekstra dhe një incentiv financiar për çdo mjek, i cili në një ditë pune shkon dhe kryen shërbim pranë spitaleve që kanë nevojë për specialistë të caktuar.

Inovacioni dhe shëndetësia elektronike konsiderohen si një ndër komponentët kyç në zhvillimin e shëndetësisë. Kjo jo vetëm nga fakti se sa shumë vlera ka marrja e informacionit në kohë reale dhe në bërjen e politikave, por mbi të gjitha në transparencë dhe llogaridhënie. Me buxhetin e vitit 2020 do të vijojmë të kemi sistemin e shëndetësisë elektronike më të fuqizuar, duke përfunduar një program të informacionit të sistemeve shëndetësore dhe duke përfunduar shtrirjen e nënshkrimit elektronik për mjekët dhe farmacistët, duke vazhduar me një sistem, i cili garanton *online* inventarin e të gjitha depove farmaceutike në shërbim të Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për të mundësuar në kohë reale jo vetëm disponibilitetin e barnave, që janë në listën e rimbursimit, por mbi të gjitha për të vlerësuar dhe për të ulur çdo risk për abuzime në sistem. Do të vazhdojmë të mbështesim një rrjet elektronik për sa i përket menaxhimit të vaksinimit në nivel kombëtar. Duke qenë se mbulesa vaksinale është një ndër objektivat që ne duam ta fuqizojmë, edhe pse ne kemi një mbulesë vaksinale shumë të mirë si vend, të pasurit një sistem elektronik, në mënyrë që të kemi në kohë reale këtë të dhënë, është shumë e rëndësishme në një kohë kur problematikat apo çështjet si hezitimi ndaj vaksinave janë në fokus të sfidave botërore. Meqenëse jam te vaksinimi, dua t'ju them se edhe vaksinimi është një program, i cili do të vijojë të mbështetet jo vetëm për vaksinat që kanë qenë, por edhe për vaksinën e re, e cila është përfshirë për herë të parë në muajin tetor të vitit 2019, që është vakcina e rotavirusit për fëmijët në muajin e dytë të katërt dhe të gjashtë.

Do të kemi një sistem të menaxhimit për bankën e gjakut. Ky sistem vjen për të garantuar dhe optimizuar nevojën që ka për gjak, ku administrimi vullnetar i tij të jetë në kohë reale dhe të kemi mundësi të një aksesit online. Shëndetësia elektronike është një paketë shumë e gjerë, e cila kërkon shumë impenjim dhe mbi të gjitha kërkon ndryshim të mentalitetit, sepse përfshin një armatë të madhe njerëzish që punojnë në të, duke filluar nga mjekët dhe infermierët, të cilët duhet të përdorin sistemet elektronike. Detyra jonë është që t'i bëjmë këto sisteme eficiente dhe të na shërbejnë ashtu siç duhet dhe për të cilën janë ndërtuar, por e rëndësishme është që ne vazhdojmë me shtrirjen e sistemeve dhe garantimin e mbulimit të sistemit shëndetësor nëpërmjet inovacionit dhe teknologjisë.

Më falni nëse u zgjata, por besoj se ishte e nevojshme të prekim këto aspekte më të rëndësishme. Sigurisht që brenda tyre ka edhe shumë elemente, programe dhe projekte, që për arsye të kohës nuk po i përmend, por jam në dispozicionin tuaj për çdo pyetje.

Faleminderit!

**Enver Roshi** –Faleminderit, zonja Ministre, për zbërthimin thuajse shterues të buxhetit!

Natyrisht që sfidat janë të mëdha, problematika shëndetësore dhe kërkesat janë gjithmonë në rritje për shërbime shëndetësore, jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi. Gjithsesi, unë dua t'ju falënderoj për futjen e vaksinës së rotavirusit në skemën e vaksinimit në Shqipëri!

Ky buxhet është i hapur për diskutim dhe, meqenëse e mora fjalën, dua të ngre disa probleme.

Ju folët këtu lidhur me mbështetjen dhe rimbursimin e kardiokirurgjisë. Ka rreth 8000 raste që mbështeten si në privat, ashtu edhe në shtet, ku kostoja e kardiokirurgjisë është e njëjtë, ndërkohë që po të shikojmë strukturën e vdekshmërisë në Shqipëri, së pari është infarkti i miokardit dhe së dyti është insulti apo aksidentet serbovaskulare. Sëmundjet e zemrës kanë invaliditet, por invaliditeti më i madh vjen nga goditja cerebrale dhe ajo që ngrihet si problem nga shumë ekspertë epidemiologë dhe klinikistë është se kjo është vrasësi kryesor, që merr më shumë jetë njerëzish në Shqipëri. Ne kërkojmë që buxheti i shtetit të parashikojë tromektominë dhe stendat **arterokarotide** të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe të gjendet një mundësi t'u vijmë në ndihmë njerëzve. Në qoftë se ditëqendrimi mesatar i këtyre sëmundjeve është më i larti i të gjitha sëmundjeve të tjera, kostoja që paguan shteti për ditëqendrimin e këtyre personave është më e larta, invaliditeti është më i lartë. Prandaj duhet që të gjendet një hapësirë dhe shteti ta shikojë me precedencë këtë mundësi.

Së dyti, ka shumë probleme me dy godinat apo me godinën e re të QSUT-së që po ndërtohet brenda në QSUT. Ajo është qendër spitalore universitare dhe mjedise akademike ka shumë pak.

Së treti, nuk janë parashikuar kushtet e mjaftueshme optimale që mjekët të kenë dhomën e tyre, dollapët e të tjerë.

Së katërti, numri i shtretërve i parashikuar në këtë buxhet është më i vogël se ai që është aktualisht.

Parashikohen 120 qendra shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë Shqipërinë, por po të keni parasysh migrimin e popullsisë drejtë zonave urbane, Tiranës dhe Durrësit, është krijuar një zbrazëti në shumë zona rurale. Natyrisht, mbulim universitar do të thotë që t'u japësh shërbim shëndetësor të gjithë njerëzve kudo ku janë. Duhet pasur parasysh që atje ku ndërtohen qendrat shëndetësore të ketë një numër të konsiderueshëm njerëzish, pra t'u shërbejmë sa më shumë njerëzve. Ky është prioriteti i ministrisë, por edhe në planin botëror fokusohen atje ku ka më shumë njerëz, natyrisht që të shkojnë më shumë investime. Pra, them që të shikohen mirë qendrat shëndetësore, sepse ka qendra shëndetësore që mund të bëhen në skaje. Për shembull, ku janë 200 apo 300 banorë në një zonë ose që janë afër zonave urbane ose që shkohet aty edhe me mënyra të tjera, por që janë afër qytetit. Për shembull, planifikohet në Berat dhe në Lezhë që të ndërtohet materniteti, por nga të dhënat e mia Lezha ka 900 lindje në vit, pra i bie mesatarisht 3 lindje në ditë. Ndoshta do të ishte më mirë përmirësimi i kushteve të brendshme i këtyre materniteteve se sa ndërtimi i maternitetit të ri për të parë zhvendosje fondesh, për të parë prioritete dhe për të ardhur në ndihmë me pajisje të brendshme, logjistike apo ekzaminime, qoftë edhe me investime në burime njerëzore. Ne po zbrazemi nga burimet njerëzore dhe duhen gjetur mjete incenativuese që mjekët të qëndrojnë në vendet ku janë apo në rrethet ku janë.

Në lidhje me Institutin e Shëndetit Publik, meqenëse vij nga kjo fushë, aty makinat e Institutit Shëndetit Publik kanë që në vitin 1980. Vetëm një makinë që ka ardhur në kohën e Gripit të Pulave është e vitit 2006, komplet makinat e tjera janë të konsumuara dhe shpeshherë njerëzit rrezikojnë jetën për të bërë një ekspertizë apo për të shkuar në zona të largëta. Është problematike jo vetëm kaq, kjo por edhe laboratorit i mjedisit atje nuk arrin të bëjë edhe disa analiza që janë hidrokarburet apo pesticidet në ujin e pijshëm. Pra, duhet parë edhe kjo. Unë nuk e di se çfarë kanë sjellë ata.

Së dyti, duhet parë edhe pjesa që punon në Institutin e Shëndetit Publik, pra duhen rritur edhe rrogat e atyre, sepse shpeshherë ngelen në ...

Në lidhje me mjekët që shkojnë në rrethe, jam dakord që mjekët që shkojnë në Korçë apo në Kukës të punojnë, por a nuk sjellë kjo një lloj diskriminimi për ata mjekë që janë atje dhe punojnë 24 orë? Ky që shkon atje merr 2 milionë e gjysmë lekë. Ai që punon në Kukës 24 orë në shërbim, ka një lloj difference. Atëherë, hajdeni të gjejmë mënyra të tjera që t'i inkurajojmë mjekët, të cilët janë nga ajo zonë që të rrinë aty. Natyrisht, qëllimi juaj është i mirë, është shumë fisnik dhe shumë human, por duhet të shikohet kjo punë, sepse krijon një lloj xhelozie, një lloj pakënaqësie tek ata të tjerët. Ai shërben atje. Unë nuk kam asgjë në këtë aspekt, sepse e thashë qëllimi është fisnik: për t'u shërbyer njerëzve dhe popullatës.

Në buxhetin që keni sjellë nuk e gjej transplantin e kockës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk përmendet.

Gjithsej janë 419 qendra shëndetësore, ju thatë që do të ketë psikolog dhe sociolog për çdo qendër shëndetësore. Pra, ne inkurajojmë qenien e një psikologu, qenien e ostersociologu, ndërkohë që në praktikë ndeshemi me mungesë mjekësh. Virovi thotë: “Mjekësia në një sens më të gjerë është mjekësi sociale”, pra mjeku kryen edhe pjesën sociale. Atëherë, hajdeni të gjejmë mundësinë që të nxjerrim më shumë mjekë, që t'i shërbejmë detyrave funksionale bazë të parandalimi i hershëm që sipas jush është *check-up* dhe trajtimit të hershëm të sëmundjeve. Mendimi im është që të fokusohemi shumë te kjo pjesë.

Së dyti, nuk dimë asgjë për specializimet. Ka shumë zona që janë të pambuluara fare në Shqipëri. Për shembull, specialistët kanë dalë në pension, ndërkohë mbeten pa kardiolog apo pa obstetër-gjinekolog. Ndoshta, duhet të parë formula e specializimit, pra krahas atyre 4-vjeçarve që kemi, të kemi edhe kardiolog atje për 1 vit. Ne bëjmë politikë këtu për popullin, nuk bëjmë politikë për akademinë. Akademia të bëjë çfarë të dojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është mendimi im. Unë u vij në ndihmë njerëzve. Ai që është atje në Gramsh, në Ersekë apo kudo tjetër të jetë një kardiolog që të bëjë diagnostikimin e të sëmurit, pra të bëjë disa detyra funksionale. Çfarë bën konsultori që është obstetër-gjinekolog? Nuk ka nevojë të bëjë operacione. Ta bëjë konsultorin e obstetrikës, konsultorin për pediatër, pra të bëjë disa funksione që t'i kryejnë atje në zonë. Nuk ka nevojë që të bëjë 4 vjet pediatri dhe të përfundojë përsëri në konsultor. Të bëjë një gjë bazë, pra ata mjekë që janë të përgjithshëm, të cilët nuk ikin nga rrethet, t'i marrim dhe t'i kualifikojmë që t'u shërbejnë njerëzve. Qëllimi ynë është t'u shërbejmë njerëzve, të mos vijnë njerëzit të verdallosen nëpër ambulanca. Unë them se buxheti duhet të rishikohet, pra të gjejë mundësi incentivuese që njerëzit të marrin shërbimin me cilësi më të lartë.

Në lidhje me kancerin e gjirit për mamografitë jam dakord me ato që ju thatë, pra mamografia duhet të bëhet e detyrueshme dhe t'u rekomandohet njerëzve që gratë t'i marrin dhe në filan ditë dhe orë të vijnë të bëjnë mamografinë, sepse kemi shkallën më të lartë të kapjes së kancerit të gjirit në stadin e tretë dhe të katërt, që është me kosto shumë të lartë mjekësore, ndërkohë që vlen më mirë të bëhet mamografia në kohë për ta kapur më shpejt. Këto ato që unë kapa përciptazi, ndoshta kolegët kanë mendime të tjera, por them se ka risit e tij. Natyrisht, si çdo buxhet nuk i kënaq të gjithë, edhe ne nuk na kënaq, as ju nuk ju kënaq në kuptimin që sa më shumë të ketë investime... Kjo është një gropë që nuk ngopet kurrë, por mendoj se duhet parë. Nuk hyra te pjesa sociale e saj, sepse është një zë tjetër, por u mora më shumë me shëndetësinë. Ndoshta kolegët e tjerë kanë mendime të tjera.

Urdhëroni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ogerta Manastirliu** – Po e filloj nga shqetësimi i parë që ju ngritët, në raport me shërbimin e ri që do të kemi, pra shërbimin e kardiokirurgjisë. Për të thënë të vërtetën, mbi 8 mijë raste që unë përmenda, nuk janë raste, të cilat janë vetëm paketë mjekësore për kardiokirurgjinë, pasi kardiokirurgjia në vit shërbimin e QSUT-së trajton rreth 600 raste, të cilët referohen për problematika të kardiokirurgjisë. Buxheti i vitit 2020 do të mbështesë shërbimin e ri të kardiokirurgjisë të “Shefqet Ndroqi”, pikërisht për arsye të listës dhe radhëve të gjata të pritjes, që janë krijuar për këtë shërbim. Pra, duke investuar më shumë në urgjencën kardiakë, duke ulur radhët e pritjes për sa u përket koronarografive, sigurisht që dalin më shumë raste, të cilat i drejtohen kardiokirurgjisë, sepse kështu shkon si fizionomi dhe ne nuk përballojmë dot vetëm me një shërbim të kardiokirurgjisë në QSUT, sigurisht më pas duke financuar jopublikun për të mundësuar qytetarët që ta marrin shërbimin në kohë, atëherë vendosëm të financojmë në një shërbim publik, që është spitali universitar “Shefqet Ndroqi” për të mbyllur dhe ciklin e shërbimit që ofrohet në këtë spital, sepse aty ofrohet paketa e koronarografisë. Ne duam që rastet e urgjencës të mos trajtohen vetëm në QSUT për sa i përket sëmundjeve kardiovaskulare dhe infarkt të miokardit, por të trajtohen edhe në spitalin universitar “Shefqet Ndroqi”, që sot ka kapacitetet me tre mjekë hemodinamiskë për të kryer koronarografinë, por nuk kishte mundësinë për të ofruar dhe nuk ka mundësi për të ofruar pa një reanimacion dhe pa shërbimin e kardiokirurgjisë për mbylljen e ciklit të plotë të ofrimit të shërbimit të urgjencës. Ndaj, ishte shumë e nevojshme që ne të investoim për hapjen e këtij shërbimi të ri, në funksion të uljes së atyre problematikave që kemi pasur për një ndër sëmundjet, që sigurisht për nga radha e sëmundshmërisë është në vend të parë, pra janë sëmundjet kardiovaskulare ato që prekin zemrën. Ndërhyrja juaj ishte me vend, për sa u përket

problemeve të goditjeve cerebrale. Dua t'ju them se kemi bërë hapa shumë të mirë në funksion të trajtimeve të reja, që ne kemi përfshirë në shërbimin e ri në QSUT, që është shërbimi “Stroke-Post Stroku”, ku tashmë ofrohet shkrirja e trombit nëpërmjet terapisë së ateplesës, por e nevojshme është që të bëjmë një hap më tutje dhe pikërisht janë ato që ju propozoni, që është edhe në objektivat tona, por është një paketë e plotë, e cila është brenda buxhetit të QSUT-së për të filluar me stendet për sa u përket këtyre ndërhyrjeve në tru. Domethënë, përpara se të vendosim buxhetin, duhet të jemi të sigurt që edhe nga pikëpamja e stafit të kemi formimin e duhur, por edhe nga pikëpamja e aparaturave të kemi mundësinë për të ofruar teknologjinë më të mirë. Pra, është një projekt tashmë i nisur me shërbimin e neurokirurgjisë dhe shërbimin e stroukut që shpresojmë të finalizohet brenda vitit 2020 për të gjetur më pas gjetur alternativa për ta referuar si një paketë shërbimi në vijim.

Për sa i përket shqetësimit tuaj në lidhje me mjediset, të cilat përdoren për studimin, për jetën akademike, qoftë të profesoratit të universitetit të mjekësisë që ofron shërbime në QSUT, por, mbi të gjitha, edhe të studentëve. “Pakti për Universitetin”, me të vërtetë na ka sjellë një qasje të ndryshme, por edhe ndryshime rrënjësore në filozofinë e investimeve që ne jemi duke bërë.

Kirurgjia e re, e cila tashmë ka përfunduar, ka mjedise të posaçme që u dedikohen pikërisht studentëve, specializantëve dhe mjekëve. Sigurisht, asnjëherë këto mjedise nuk mund të jenë aq të mëdha, sa të akomodojnë personel ekstra, në raport me kapacitetet që ka QSUT-ja, por pikërisht se ka kapacitete edhe spitali “Shefqet Ndroqi” duhet të alternojnë shërbimit edhe në spitale të tjera universitare, gjithashtu edhe te spitali i “Traumës”. Pra, në ambientet i kemi dhe duhet t'i shfrytëzojmë më mirë dhe këtë jemi duke bërë nëpërmjet “Paktit me Universitetin”. Ndërkohë, spitali i ri i sëmundjeve të brendshme, përsëri një investim i qeverisë shqiptare në vlerën 14 milionë euro, që përfundon në vitin 2021, do të jetë një spital, i cili do të ketë më shumë se 9 klasa leksionesh dhe ambiente, të cilat do të jenë ambiente ndihmëse për studentët, specializantët dhe mjekët, të cilët do të transferohen nga struktura e 6-katëshit që është sot, në këtë spital të ri të sëmundjeve të brendshme.

Gjithashtu, edhe spitali i pediatriisë, sapo ka filluar pikërisht investimi, do të ketë ambiente të posaçme për leksionet dhe për t'u shërbyer sa më mirë, për t'i akomoduar sa më mirë mjekët dhe specializantët, që ushtrojnë detyrën e tyre brenda këtyre strukturave.

Është pikërisht “Pakti për Universitetin”, por, mbi të gjitha, edhe ligji “Për arsimin e lartë”, i cili na drejton që çdo vendimmarrjeje brenda sistemit tonë universitar të shërbimeve, duke thënë se këto financohen nga Ministria e Shëndetësisë, të jetë në plan të parë për ne. Por duhet kuptuar që ka nevojë edhe për racionalizim, edhe për optimizim, edhe për një organizim



më të mirë të punës brenda shërbimeve, pra le t'i shikojmë pak të gjitha këto aspekte dhe të mos kërkojmë vetëm ato që nuk kemi, por të mundohemi që ato që kemi t'i shfrytëzojmë pak më mirë, sepse ka mundësi që edhe sot brenda QSUT-së të shfrytëzohen më mirë ambientet dhe universiteti të financojë për këto mjedise, sepse në fund të ditës është një partner vital i sistemit shëndetësor, pa të cilin ne nuk bëjmë dot. Sigurisht, spitali mund të bëjë pa universitetin në disa çështje baze, por shëndetësia nuk bën dot pa universitetin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra është një herë spital, pastaj është universitar. Meqenëse ligji praktikisht e parashikon kështu, ne jemi të gatshëm, por duhet të vijmë përballë nevojave të njëri-tjetrit dhe me sa mundësi kanë të dyja palët, edhe universiteti, si një strukturë që ka autonominë e saj edhe në financim, edhe Ministria e Shëndetësisë që punon për t'u garantuar qytetarëve shërbime sa më të mira, për t'u garantuar mjekëve kurse pune sa më të mira që të ketë mundësi të optimizojnë burimet që kanë në funksion të shërbimeve të reja.

Dua të ndalem pak te çështja e qendrave shëndetësore: 120 qendra shëndetësore dhe ambulanca. Më besoni që një ndër shqetësimet e mia që në momentin e marrjes së detyrës ka qenë ky: të mos miratoj asnjë investim për hatër të asnjë deputeti apo grupi interesi, kur ky nuk ka interes real për qytetarët. Ne nuk jemi të pasur për të shpenzuar aty ku nuk ka nevojë. Ndaj çdo qendër shëndetësore dhe ambulancë që është ndërtuar, por edhe çdo spital meqenëse përmendët Lezhën, (nuk e di, a keni qenë ndonjëherë në maternitetin e Lezhës)...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, po jua shpjegoj unë. Materniteti i Lezhës është një maternitet, i cili është brenda qytetit të Lezhës, ndoshta 2-3 kilometra jashtë strukturës aktuale të spitalit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, po e them për spitalin e Lezhës. Pse duhej materniteti? Materniteti po ridimensionohet edhe si shërbim. Po përfshihet brenda korpusit të spitalit të Lezhës, ashtu sikurse po bëhet dhe me maternitetin e Beratit, ku ka qenë një strukturë që tashmë nuk ekziston më. Është përfshirë brenda korpusit për të maksimizuar shërbimet, duke u reduktuar, ashtu siç na drejton epidemiologjia dhe ndryshimet demografike numrin e shtretërve, duke referuar më shumë shërbime dhe shërbimet horizontale, sepse një maternitet, një shërbim nuk ka nevojë vetëm për sallat e lindjes, ka nevojë për laboratorin, ka nevojë për diagnostikën, ka nevojë për të bërë ndërhyrje. Me të vërtetë, mund të jenë mbi një mijë lindjeje në Lezhë, por ndërkohë mjekët specialistë, që kemi në Lezhë kryejnë edhe ndërhyrje gjinekologjike shumë të ndërlikuara dhe ne duam t'i zhvillojmë spitalet në të gjitha shërbimet e tyre. 4 shërbimet bazë janë në çdo spital. Sigurisht, nuk dua t'i përsëris. Një prej të cilëve është edhe shërbimi

obstretik-gjinekologjik, që është shumë i nevojshëm të jetë në standardet bashkohore. Çili është vizioni këtu? Është se këto spitale, përveçse mund të mbulojnë qarkun mund të mbulojnë komplet zonën e Veriut, pavarësisht se Shkodra dhe Dibra kanë spitalet e tyre. Por, në qoftë se Lezha bëhet një spital mirë bëhet referencë edhe për Veriun, ne operatorin e kujdesit shëndetësor e kemi ngritur në katër rajone të vendit, pikërisht për t'u identifikuar edhe shërbime të ndryshme, për t'i fuqizuar ato dhe për t'i bërë kompetitive me spitalet e tjera, qoftë në Jug, qoftë në Tiranë, pra në zonën qendrore të Shqipërisë. Pra, filozofia e shërbimeve ka ndryshuar në raport me investimet dhe në raport me qasjen. Ne jemi duke investuar aty ku ne do të kemi pikërisht investimin, duke e kthyer këtë në më shumë shërbime për qytetarët dhe në më shumë shërbime më cilësore për qytetarët. Ndaj çdo investim që po realizohet jo vetëm që nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë një qokë për të bërë një qendër shëndetësore, meqenëse kemi premtuar. Përkundrazi, po bëjmë qendra shëndetësore dhe ambulanca aty ku është e nevojshme, aty ku ka banorë, ku ka një standard, i cili është raporti i popullatës me territorin dhe në këtë lloj vlerësimi jemi duke identifikuar edhe 120 qendrat e ardhshme.

Për sa i përket bonusit, keni të drejtë kur thoni të gjejmë incentiva, por inventivi ky është 2,5 milionë lekë plus pagën. Nuk është incentivë, ky për çdo mjek që të shkojë dhe të kërkojë shërbime jashtë Tiranës?! Mendoj se është goxha mbështetje direkte për mjekët. Ne duam të ofrojmë shërbime për qytetarët. Vetë mjekët që janë nëpër këto spitale, na i kanë kërkuar që të vijmë mjekë. Nuk i përballojnë dot turnet dhe radhët e gjata. Ndoshta nuk është thënë, por duhet thënë që mjekët në spitale tona edhe rajonale, por edhe bashkiake, paguhen më shumë se mjekët këtu, duke qenë se bëjnë roje më shumë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, po i kam me shifra këto që po ju them, duke qenë se bëjnë roje më shumë, u shkon paga edhe më shumë se spitaleve. Një ditë mund të kemi ndoshta një takim ose edhe dëgjese për të parë se sa shkon paga e një mjeku brenda sistemit me të gjitha shërbimet ekstra që ai merr, duke përfshirë këtu edhe vështirësitë në punë, duke përfshirë edhe rojet, të cilat janë rritur, janë dyfishuar në vitin 2017. Rritja e rojeve ka bërë që të gjithë mjekët të marrin më shumë. Duke qenë në spitalet publike edhe të vetëm apo vetëm me një kolegë, bëjnë më shumë roje dhe marrin dhe më shumë pagesë ekstra. Kështu që janë vetë mjekët që na kanë kërkuar ne të kemi suport dhe të na vijmë mjekë për t'u shërbyer njerëzve më mirë. Besoj se bonusi 2,5 milionë plus pagë është një incentivë shumë e mirë nga pikëpamja financiare për çdo mjek që kërkon të ofrojë shërbime, por edhe për sistemin që kërkon t'i incentivojë mjekët. Po ashtu edhe sistemi i patronazhit, ku 100 mijë lekë në ditë është dedikuar, plus shpenzimet operative, kostot që kanë për dietat për mjekët që ofrojnë shërbime në rrethe nga spitali universitar në

spitalin rajonal dhe 50 mijë lekë nga spitali rajonal në bashkiak. Shpresoj se isha ezauruese. Më thoni nëse kam harruar diçka.

**Enver Roshi** – Urdhëroni!

**Klodiana Spahiu** – Faleminderit!

Realisht, dua t'ju përgëzoj për mënyrën se si e keni hartuar këtë buxhet. Nuk dua të jem përsëritëse e të gjitha projekteve që ju përmendët, sepse pa dyshim ishin me të vërtetë projekte shumë të rëndësishme, duke u fokusuar në 4 fushat: në parandalim, në promocion dhe në mjekim, por edhe në dy fushat kryesore që ju jeni përqendruar në shëndetin e gruas. Megjithatë, krahas të gjitha punëve të mira që janë bërë, dua thjesht edhe për kolegët e komisionit të rikujtoja, sepse sa herë bëhen mbledhjet e buxhetit rikujtojmë situata që kemi kaluar këtu me një pjesë shumë të mirë edhe të nëpunësve të Ministrisë së Shëndetësisë. Në vitin 2014 kemi bërë goxha debat të madh se si do ta realizonin në mjekimin e infarktit akut të miokardit dhe kishin shumë njerëz kundër, ishin kundër atij lloji investimi që në atë kohë propozoi Ministria e Shëndetësisë. Në fakt, sot jemi në një hap tjetër, që mendoj se është evolucion dhe është evolucion goxha i madh. Ne jemi fokusuar atje, ku duhet për përballimin e problemeve që prekin më shumë shëndetin e shqiptarëve. Sot ne e kërkojmë dhe është një lajm shumë i mirë nga ju kur thoni që është paketa gati edhe për trajtimin e aksidentit vaskular cerebral. Kjo është një gjë pozitive dhe ne duam që brenda një afati kohor kjo të merrte një përgjigje pozitive, sepse realisht, ashtu siç e nënvizoi edhe nënkryetari i komisionit, shkalla e invaliditetit është shumë e lartë për shkak të këtyre sëmundjeve. Megjithëse rastet që kërkojnë trombektomi, mund të jenë të pakta, krahasuar me numrin e lartë të shtrimeve në strokë, përsëri ato pak raste përfitojnë dhe rehabilitohen, siç rehabilitohet trajtimi i një infarkti akut të miokardit. Ne gjithmonë fokusohemi te problemet e shëndetit, sepse një pjesë këtu jemi edhe mjekë, duke filluar nga kryetari, që mbulojnë fushën e shëndetit publik, që është kaq e rëndësishme, por nuk duhet të harrojmë se ka edhe disa probleme të tjera. Është shumë e vështirë që në një seancë dëgjimore me ju ne të adresojmë të gjitha problemet që mund të ketë çështja sociale dhe shëndetësia. Dua të fokusohem në disa pika, që ndoshta na kanë mbetur edhe nga buxhete e kaluara. Së pari, një pikë e rëndësishme është qendra kombëtare e rehabilitimit, të cilën ne e kemi diskutuar edhe vjetër me ju. Shtimi i numrit të aksidenteve i ka shtuar shumë edhe rastet, të cilat mbeten me dëmtime, pjesa më e madhe të parikthyeshme.

Në takimet e vazhdueshme që kemi me qytetarët del problem pjesa e rehabilitimit postraumatik, jo vetëm për shkak të sëmundjes, por edhe për shkak të aksidenteve. Në këtë buxhet nuk është parashikuar, por, nëse është e mundur, të jetë në prioritetet tuaja. Të paktën,

në Shqipëri të ekzistojë një qendër e vetme ose të gjendet një mënyrë për t'i mbështetur këta njerëz, që janë në qendrat tona spitalore.

Gjithashtu, ju përmendet një investim shumë të mirë për Qendrën e Kardiokirurgjisë në Sanatorium. Ky është një investim shumë i mirë dhe duhet perceptuar pozitivisht nga të gjithë qytetarët shqiptarë, sepse, pavarësisht kontratave me strukturat private, radha e pritjes ka qenë e gjatë dhe ky problem është diskutuar shumë herë në Komisionin e Shëndetësisë.

Gjatë diskutimit të buxhetit, grupet e interesit kanë sjellë shumë kërkesa në komision. Një kërkesë nga Universiteti i Mjekësisë më ka bërë shumë përshtypje. Aty flitet për një studim të bërë për depistimin neonatal të dëgjimit në maternitete, një projekt shumë mirë i detajuar. Kjo është tashmë një praktikë shumë e mirë, që bëhet në të gjitha vendet e Europës, për depistimin sa më të shpejtë të fëmijëve që lindin me probleme të dëgjimit. Nëse kjo korrigjohet, vitin e parë është e ... Doktoreshë Edlira është përfshirë më shumë në këtë problem. Shpresoj të ketë hapësirë për mbështetjen e këtij projekti.

Ndërkohë, ka kërkesa nga shumë shoqata, megjithatë, siç është vizioni juaj, që thoni: “Ne duam që investimi të shkojë atje ku duhet dhe jo atje ku e kërkojnë njerëzit me influencë.”, po përjashtoj deputetët, se nuk hyjmë tek ata njerëz...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dikur.

Nëse do të ishte “dikur”, nuk duhej përdorur sot.

Do të mbetem në një problematikë të rëndësishme, që është mbarëbotërore, jo vetëm jona. Në fjalën tuaj u diskutua gjatë shëndeti i fëmijëve dhe ju përgëzoj për këtë.

Për sa i përket autizmit, duhet të bëjmë më shumë, sepse kemi shumë gjëra mangut. Familjeve që kanë fëmijë autikë u kanë ardhur kërkesa për pjesën stomatologjike, që është vërtet shumë e vështirë për t'u realizuar.

Ne si komision duhet të fokusohemi te shëndeti i rinisë. Rinia është grupmosha më e shëndetshme dhe me më pak probleme shëndetësore, por unë kërkoj një fokusim më të madh të të gjitha qendrave të shëndetit publik në Shqipëri për shëndetin riprodhues dhe seksual të rinisë. Kjo është një problematikë e rëndësishme. Rinia mund të ketë informacion, por ka shumë pak hapësira, ndaj, shumë miqësisht, kërkoj që ne si komision, por edhe ju si ministri, të bëjmë më tepër, sepse një edukatë e mirë shëndetësore për riprodhimin, një shëndet i mirë i një nëne të ardhshme dhe një familje e mirë në të ardhmen, janë investime të vogla, por kanë një përgjigje shumë të madhe.

Për sa u përket çështjeve sociale, kemi pasur kërkesa nga shoqata e romëve dhe egjiptianëve, që kolegët do t'i përmendin. Ata kërkojnë me insistim një praktikë të re që është

zbatuar në Rumani shumë vjet më parë: mediatorët e punësimit, mediatorët e shëndetit dhe mediatorët e arsimit. Me të drejtë, edhe unë, kur e dëgjova si koncept, nuk m'u duk shumë i domosdoshëm, por rikthehem në situatën që kemi në qarkun e Durrësit. Në një zonë të caktuar patëm problem me tuberkulozin. Vuajtëm shumë në atë periudhë kohë, sepse e kishim shumë të vështirë të kontaktonim këto familje për të gjetur një njeri që t'i bindte këta njerëz. Besoj se mediatori i shëndetit, që mund të jetë edhe një punonjës social, por duhet të jetë burim njerëzor që vjen nga ky kontingjent, që janë shumë të kualifikuar. Po të shikoni, ka të rinj romë dhe egjiptianë shumë mirë të kualifikuar, të shkolluar dhe e bëjnë në mënyrë perfekte këtë punë. Megjithatë, ky është një sugjerim pozitiv. Ndoshta nuk mund të jetë detyrues, por besoj që në zona të caktuara ne mund ta realizojmë dhe nuk mendoj se ka kosto të madhe.

Një kërkesë e fundit e ardhur në komision në vitin 2015 është nga Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve, e cila kërkon një shumë prej 600 milionë lekësh, dhe besoj se duhet t'i japim një zgjidhje. (Nuk është e juaja ndoshta, por e Komisionit të Ekonomisë).

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne si komision ia kemi nisur Komisionit të Ekonomisë çdo vit, ndaj është e tepruar ta ridërgojmë disa herë. Ata e kërkojnë këtë shumë për funksionimin e qendrës. Ndoshta duhet gjetur ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të nderuar kolegë, i keni kërkesat mbi tavolinë. Ata e kanë detajuar, sepse është një kërkesë e përsëritur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, por të paktën t'u thuhet të mos e sjellin më, sepse për 1,2,3,4 arsye...

Ata na kanë sjellë në mënyrë të detajuar procese gjyqësore, që i kanë fituar. Këto ishin pikat që doja të përmendja.

E fundit, është kërkesa e kryetarit të komisionit për mjediset mësimore për studentët. A keni ndonjë plan se çfarë do të bëhet me 6-katëshin si godinë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, 6-katëshin, që është aktualisht. Unë kam dëgjuar një herë nga rektori nëse mund të bëhet transformim i kësaj godine në një qendër?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, kjo godinë ka hapësirë të mjaftueshme.

Faleminderit!

**Ogerta Manastirliu** - Të kthej përgjigje për këtë të fundit, sepse e kam shumë konkrete?

*(Mungesë incizimi)*

**Roland Xhelilaj** – Duhet bërë pyetje, që të japim përgjigje.

**Roland Xhelilaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Pyetja mund të duket e përsëritur, duke marrë në konsideratë shpjegimin shumë shterues që ju i bëtë buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Duke u nisur nga kërkesat e kryetarit dhe nënkryetares, mendoj se duhet të kërkoj një përgjigje nga ju, e cila mund të jetë edhe e përsëritur.

Projektbuxheti i vitit 2020 në themel të tij ka mbështetjen e reformave të nisura me bazë konsolidimin fiskal, rritjen ekonomike, por edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Ju me të drejtë e theksuat fort përmirësimin e politikave nëpërmjet konsolidimit të paketave të trajtimit të sëmundjeve, por edhe afrimit të paketave të reja e të tjera.

E para, i keni të krahasuara shpenzimet për shëndetësinë ndaj prodhimit kombëtar me faktin apo planin e vitit 2019? Sa parashikohet të jetë fakti i vitit 2019 dhe sa parashikohet të jetë për vitin 2020?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të mbaroj, sepse kam 3 pyetje.

Gjatë shpjegimit të ministres dëgjova problemin e shpenzimeve për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Shpërndarja m'u duk shumë e drejtë, për të kuptuar edhe grupet mbështetëse, por, të paktën, për ne që merremi me shifra, duket sikur jeni në nivelet e vitit 2019.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jeni në nivelet e vitit 2019 në total, me një rritje shumë të vogël, në një kohë kur ju thoni se numri i familjeve, po e marr në konsideratë, nga 66 mijë e 500, do të bëhet 65 mijë në vitin 2022, do të thotë se ulja është shumë e vogël, ndërsa numri i përfituesve të personave me aftësi të kufizuar është shumë i madh, nga 160 mijë në 166 mijë brenda viti 2020.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

160 mijë është raportimi juaj në buxhet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A është i mjaftueshëm ky fond për të bërë atë që ne duam?

Ne si komision nuk ngopemi me fondet që duhet të marrë Ministria e Shëndetësisë në të gjitha drejtimit e saj, jo vetëm si shëndetësi, por edhe si mbrojtje sociale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetje.

Nuk ishte pyetje kjo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E treta, meqenëse ju thatë “pa ndërhyrjen e deputetëve”, më vjen mirë është menduar të mbyllet brenda vitit 2020 Pediatria e Durrësit, por më bën pak përshtypje shpërndarja e fondeve për vitet 2018–2019, megjithëse në fundin e vitit 2018 fondi ishte 80 mijë, dhe brenda vitit 2019 është 120 mijë. Do të mbyllet, apo jo?

*(Mungesë incizimi)*

**Roland Xhelilaj** – Është normale të kemi shumë pyetje dhe diskutime për të bërë, sepse është një fushë pa fund.

Unë po i lë të gjitha fjalët që kisha përgatitur, të cilat ishin fjalë të mira për ato që janë bërë për shëndetësinë, dhe shumë të mira për ato që parashikohen të bëhen në vitin 2020. Shkurtimisht, po bëj pyetjet, meqenëse e kemi kohën të kufizuar.

Gjatë këtij viti kemi miratuar dy ligje në Kuvend: i pari për çështjet e shëndetit të fëmijëve dhe të të rinjve, që ishte përmirësimi i ligjit për ndalimin e përdorimit të alkolit dhe pijeve energjike nga fëmijët. Unë dua të di a ka evidenca se si ka shkuar zbatimi i ligjit nga momenti i hyrjes në fuqi. A ka pasur shkelje të ligjit dhe a janë ndërmarrë sanksione?

Pse e shikoj si një çështje buxheti? Nëse ne kemi apo jo kapacitete të mjaftueshme për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjit, a kemi mundur ta kontrollojmë deri tani? Nëse jo, ka ndodhur për arsye mungese buxhetore, apo duhen më shumë kapacitete?

E dyta, për herë të parë mbas shumë vitesh debate e diskutimesh, miratuar të merrnin pagesë edhe personat invalidë që nuk kishin një vit të siguruar në 5 vjetët e fundit. Si ka shkuar, sepse ishte trajtuar vazhdimisht si një çështje buxheti të pamjaftueshëm, si një problematikë në prishjen e skemës së sigurimeve shoqërore, nëse do të miratohej, por u vendos që ata të marrin trajtim nga shërbimi social. A keni informacion sa persona kanë përfituar nga hyrja në fuqi e ligjit? Si jemi me përballimin e buxhetit për këtë ndihmë? A parashikohet të rritet në të ardhmen, apo do të jetë një shifër konstante?

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Amra Borova** – Faleminderit, zonja Ministre!

Siç e tha edhe kryetari, është një grupë shumë e madhe, ku nevojat janë shumë të mëdha.

Do të ndalem në Spitalin Rajonal të Shkodrës, ku kërkesat fillojnë me rregullimin e infrastrukturës. Normalisht, është një armatë shumë e madhe punonjësish, por është një armatë shumë herë më e madh e pacientëve që marrin shërbim, ndaj infrastruktura dhe pajisjet amortizohen shpesh. Kërkesa e Spitalit Rajonal të Shkodrës është për rikonstruksionin e sallave

të operacioneve, rregullimin e gjeneratorit në raste avarie, sespse është jashtë funksionit dhe është shumë problematik për mjekët e këtij spitali. Po ashtu, ka probleme salla e reaminacionit dhe ashensori nuk shkon deri në katin e fundit, ku penalizohen pacientët për daljen apo hyrjen jashtë me anë të barrelës në mjediset e spitalit. Ndërkohë, Reparti i Fizioterapisë përmytet shpesh nga uji. Këto janë shqetësimet e Spitalit Rajonal të Shkodrës.

Pak më parë ju thatë se në vitin 2020 do të jenë në fokus gratë dhe fëmijët. Para disa muajsh isha pjesë e stafit të mjekëve të Shërbimit Shtetëror Stomatologjik të Shkodrës, i cili është fokusuar në Poliklinikën e Shkodrës. Nuk do të përmend problematikat ose nevojat që mund të ketë Poliklinika e Shkodrës, por po fokusohem te stomatologjia. Ka vite që unitet nuk ndryshohen. Kjo është një kërkesë personale, meqenëse deri para pak muajsh isha mjek stomatolog në atë repart, që depistimet bëhen 100% dhe është një punë kolosale e mjekëve stomatologë. Janë 10 doktoresha dhe 6 infermiere, ndërkohë që 3 unite kanë dalë jashtë funksionit dhe mjekët stomatologë detyrohen të dublojnë dhomat me njëri-tjetrin, pavarësisht se fëmijët nga 0 deri në 18 vjeç marrin një shërbim falas. Nuk është një numër i vogël, por janë 50 fëmijë në ditë që marrin një shërbim cilësor. Nuk e di sa informacion real mund të keni, por Shkodra është i vetmi vend që aplikon shërbimin stomatologjik falas dhe ka një kërkesë shumë të madhe. Fëmijët janë të ndërgjegjësuar për këtë pjesë.

Do të më pëlqente shumë të realizohej kjo gjë, ndoshta edhe jashtë buxhetit, me anë të donatorëve, për të mos rënduar buxhetin e shtetit, sepse ka shume fluks dhe kërkesa. Pse të mos marrin një shërbim cilësor, përderisa fëmijët vijnë dhe janë të ndërgjegjësuar në këtë pjesë?

Ka edhe disa kërkesa shtesë, sepse, përderisa punohet me fëmijë, mjediset duhet të kenë ngrohje dhe ftohje. Do të ishin shumë komode, përveç nevojave për unite. Nuk po flas për furnizimin e materialeve, sepse ka mungesa, por vijnë herë pas here. Uniti nevojitet më shumë, sepse i penalizon për të punuar me fëmijët.

Duke anashkaluar pjesën që ishim, “Tetori rozë”, nuk e di vërtetësinë, por dua të bëj një pyetje: në Repartin Onkologjik doktoreshat kanë referuar për mungesë të citostatikëve. Ka disa javë që Spitali i Shkodrës nuk po furnizohet. Pacientët janë adresuar në Spitalin e Tiranës ose i blejnë privatisht. Përderisa është një propogandim shumë i mirë dhe ndërgjegjësimi është bërë me hapa kolosale kohët e fundit, do të më pëlqente që këto mungesa të mos dëgjoheshin as për Shkodrën, as për Lezhën, as për Tiranë, as nëpër spitale të tjera, përderisa kaluam muajin e ndërgjegjësimi, ku propoganda dhe ndërgjegjësimi është shumë i madh.

**Ilirjan Pendavinji** – Fjalët e mira dhe diskutimet po i zëvendësoj me një buzëqeshje për ministren. Po vazhdoj me pyetjet.



Sa mjekë në Shqipëri e kanë marrë bonusin e mjekëve kur shkojnë në zona të largëta?  
Sa mjekë dhe sa zona kanë përfituar?

Kam një koment të vogël. Bërja e rojeve që bëhet nëpër rrethe është vërtet lodhësë dhe rraskapitëse për mjekët, sepse unë e di çfarë heqin ata, sepse kemi punuar të gjithë mjekë dhe e dimë se çfarë të rrish roje. Pasi punon 36 orë, je i ezhauruar komplet, si nga ana mendore dhe fizike.

E dyta, më ka shqetësuar shumë ikja e njerëzve që shkollohen si infermierë dhe doktorë në vend dhe, pasi mbarojnë shkollimin, ikin jashtë. Cilat janë politikat e këtij viti për të rritur qëndrueshmërinë e mjekëve dhe për t'i incentivuar të punojnë në sistemin tonë shëndetësor?

Faleminderit!

**Adelina Rista** – Unë dua t'ju falënderoj për paraqitjen e projektbuxhetit, zonja Ministre! Nuk do të shkoj më tej në diskutime, sepse mjafton falënderimi, dhe për efekt të kohës do të kaloj direkt në propozimet për projektbuxhetin.

Në aneksin 4 të projektbuxhetit të vitit 2020, në funksionet që financohen nga transfertat specifike, për vitin 2020 janë përfshirë edhe disa qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, siç është Kuçova dhe Kukësi. Fieri ka qendrën ditore “Horizont” për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku ka një personel prej 18 punonjësish, psikologë, punonjës socialë, fizioterapistë dhe logopedistë. Në vitin 2018 kjo qendër ka qenë një bashkëfinancim i Bashkisë Fier me një projekt italian, i financuar nga qeveria italiane dhe qendra “Morialdo” deri më 22 tetor të vitit 2016. Nga data 22 tetor i vitit 2016 Bashkia Fier e ka nën juridiksionin e vet dhe përgjigjet për gjithçka për këtë qendër fëmijësh me aftësi të kufizuara. Për projektbuxhetin kemi kërkesë që në transfertën për mbrojtjen sociale të përfshihet edhe qendra për fëmijët me aftësi të kufizuara “Horizont” e Bashkisë Fier, sepse aty trajtohen 90 fëmijë me aftësi të kufizuar. Faktikisht ka një personel me 18 punonjës, ndaj pse të mos mbështetet edhe Bashkia e Fierit me një financim të tillë nga buxheti i shtetit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Gjithashtu, dua të them se Fieri ka një staf shumë të kualifikuar mjekësh dhe infermierësh, një personel shëndetësor, që, faktikisht, gëzon respektin e të gjithë qytetarëve të Fierit. Prandaj, edhe e ngritëm qendrën “Horizont”, sepse në këtë qendër vijnë fëmijë jo vetëm nga Bashkia e Fierit, por vijnë edhe nga bashkitë e tjera të qarkut Fier, siç është Roskoveci dhe Patosi. Spitali i Fierit ka një staf shumë të kualifikuar, të cilët punojnë me dëshirë. Unë e falënderoj ministrinë për investimet që ka bërë në spitalin rajonal të Fierit, e cila vitin e shkuar hapi hemodinamikën, qendrën e trajtimit të kancerit e të tjerë. Në Fier nuk mjafton rikonstruksioni i pjesshëm i godinës së spitalit, pasi duhet një godinë e re. Projekti është bërë,

por nuk është parashikuar në këtë buxhet. Unë mendoj se ju, zonja Ministre (qofshit sa më gjatë në këtë ministri), keni si qëllim ndërtimin e një godine të re për spitalin e Fierit.

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Zoti Florenc, shumë shkurt.

**Florenc Spaho** – Po shumë shkurt do të flas.

Unë dua të bëj në falënderim për ministren dhe për stafin e saj për hartimin e këtij projektbuxheti, pasi një shprehje thotë: “Kush nuk falënderon njerëzit, nuk ka falënderuar Zotin”.

Nisur nga fusha që vij, duke qenë se buxheti kishte katër principe, ku një ndër to ishte parandalimi, mendoj se duhet të futet në projektbuxhet edhe një fond për depistimin e fëmijëve nga mosha 10 deri në 14 vjeç, kryesisht për fëmijët që diagnostikohen me skoliozë, duke qenë se ky numër sa vjen dhe rritet. Unë nuk do të them një shifër konkrete, pasi është pak alarmante, por nga puna që kam bërë më parë me depistimet në disa shkolla në qytetin tim, 1 në 5 fëmijë ka rezultuar me skoliozë.

Skolioza është një sëmundje me origjinë idiopatike, pra nuk dihet kryesisht se nga vjen, ndoshta vjen nga mbajtja e çantës shkollore, ndoshta vjen nga ushqimet, ndoshta nga jeta sedentare; ndoshta nga mosushtrimi i aktiviteteve fizike apo shumë shkaqe të tjera. Pra, do të ishte mirë që depistimi të kryhej në shkolla, kryesisht te grupi i moshave që kanë një rikthyeshmëri deri në masën 100%. Shkalla e përqindjes së skoliozës, deri në moshën para pubertetit, nuk është shumë e madhe dhe ka një rikthim deri në masën 100%. Në qoftë se trajtohesh pas kësaj moshe, kjo sëmundje lë pasoja dhe nuk mund të bëhet rehabilitimi.

Së dyti, më pëlqeu shumë që ministrja përmendi fëmijët me aftësi ndryshe, pasi duket se ka një fokus shumë të madh për këtë kategori. Është një lajm i mirë për këta fëmijë, sidomos për prindërit e tyre, pasi nga 70% e buxhetit që ishte, tani kjo kategori e fëmijëve mbulohet me buxhet në masën 100%. Unë do të doja që edhe në shpërndarjen e 412 qendrave shëndetësore, meqenëse ministria e ka marrë këtë nismë për psikologë apo për punonjës socialë, duhet patjetër të futet edhe roli i fizioterapistit, por jo çdo fizioterapist, kryesisht duhen fizioterapistë, të cilët kanë marrë specializime bazë për psikomotricitetin.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Faktikisht pyetjen e tretë e bëri shumë mirë daktreshë Klodi. Në vijim të asaj që ajo tha, dua të shtoj se ne jemi një nga vendet e vetme në Ballkan që nuk kemi një qendër rehabilitimi të mirëfilltë. Patjetër që nevojitet rimbursimi pjesërisht për këta persona, të cilët rehabilitohen jashtë Shqipërisë. Unë do të them një shifër konkrete se sa shkon rehabilitimi në Janinë, që është mbi 350 euro nata, në Selanik është 500 euro dhe në Firence 700 euro. Pra,

besoj se kjo është një kosto e papërballueshme për buxhetin e shtetit. Ne kemi burimet tona njerëzore, kemi edhe kushtet, ndaj mund ta bëjmë vetë një qendër rehabilitimi, siç po bëhet qendra e rehabilitimit për fëmijët me aftësi ndryshe, e cila do të jetë shembull dhe më pas do të shpërndarjet në disa qytete kryesore. Ndaj, mund të bëhet edhe një qendër rehabilitimi në Tiranë për të sëmurët e tjerë apo në një zonë tjetër, duke qenë se ne i kemi specialistët tashmë për ta bërë.

**Enver Roshi** – Pyetja tjetër cila është?

**Florenc Spaho** - Faleminderit, zoti Kryetar dhe zonja Ministre, për durimin! Ne duhet ta ftojme më shpesh zonën Ministre që të vijë këtu, pasi kemi shumë pyetje.

Faleminderi!

**Enver Roshi** – Vetëm Tajvani dhe Suedia kanë qendra rehabilitimi të financuara nga shteti, kurse të tjerët janë copë-copë.

Zonja Ministre, mund të përgjigjeni.

**Ogerta Manastirliu** –Ju përmendët me shumë të drejtë spitalin e Shkodrës dhe vëmendjen që duhet të kemi ne për këtë spital. Unë jo vetëm që jam në dijeni, por shkoj periodikisht në Shkodër, madje nesër do të jem në Shkodër për të parë nga afër se si shkojnë shërbimet shëndetësore në spitalin rajonal. Dy janë momentet kryesore: së pari, spitali i Shkodër merr më shumë buxhet nga të gjitha spitalet e tjera rajonale.

Së dyti, spitali i Shkodrës duhet të vendosë në përdorim me më shumë efeciencë ashensorët dhe gjeneratorët. Më vjen keq, këtë gjë duhet ta them, por nuk merret Ministra e Shëndetësisë me administrimin e punëve rutinë në Shkodër. Sigurisht ne merremi me çfarëdolloj shërbimi tjetër që cenon qytetarët, sepse ky është fokusi i punës sonë. Ne jemi duke krijuar grupe, të cilat menaxhojnë dhe administrojnë në kohë problematikat brenda spitaleve, që do të thotë se edhe drejtori i një spitali rajonal futet brenda këtij grupi dhe është në kontakt të përditshëm me ministrinë për çdo lehtësim që mund t'u japim lidhur me çështje të procedurave apo me çështje operative. Sigurisht, unë nuk dua t'i shmangem këtu përgjegjësisë, sepse gjithmonë përgjegjësia do të jetë imja, por çështjet e administrimit të brendshëm janë çështje ditore të spitaleve. Ne, si ministri, mund të sigurojmë që t'i ndjekim në përditshmëri punët e vogla, të cilat shkaktojnë problematika në spitale dhe që kërkojnë përgjegjësi për ndjekjen e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht këtë jam duke thënë që krijimi i strukturës së operatorëve (Shkodra ka një operator rajonal, që mbulon të gjithë zonën veriore: Shkodër, Lezhë dhe Kukës) jep pikërisht edhe mbështetjen për problematikat që spitali apo poliklinika mund të kenë, gjithashtu, edhe

për shërbimin stomatologjik, që ju e përmendët. Shërbimi stomatologjik dhe shumë shërbime të tjera janë të mira jo vetëm në Shkodër, por edhe Elbasan, edhe në Tiranë. Keni shumë të drejtë lidhur me çështjen e planifikimit për shërbimin e dentistrisë që duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi. Kjo është publike dhe e kemi në fokus. Fokusi ynë është, ashtu siç thatë edhe ju, që në vazhdim të ketë materiale dhe unite. Vitin që shkoi ne bëmë një investim në Klinikën Stomatologjike Universitare në Tiranë me unite të reja dhe, sigurisht, brenda projekteve që ka Ministria e Shëndetësisë, në fokus është edhe Shkodra për rinovimin e uniteve dentare.

Po vazhdoj me përgjigjet e pyetjeve të nënkryetares për sa i përket Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit, duke qenë se kjo ishte edhe kërkesa e Florencit.

Ne nuk kemi buxhet këtë vit për Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit, por dua të siguroj një gjë: ne kemi shërbim të rehabilitimit për fëmijët, që është Qendra Kombëtare e Zhvillimit dhe Mirëritjes së Fëmijëve, kemi shërbim të rehabilitimit brenda spitaleve universitare, gjithashtu, Spitali i Traumës ofron një shërbim rehabilitimi, kemi shërbim të rehabilitimit ambulator brenda QSUT-së me shërbimin e fizioterapisë, si dhe brenda shërbimit të neurologjisë. Pra, brenda të gjitha spitaleve neurologjike kemi edhe qendra...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, po e kemi një shërbim të tillë te neurologjia. Këtë e di, pasi e kam bërë vetë aty.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, kur ti je brenda spitalit merr edhe shërbim fizioterapie, por, në qoftë se hospitalizohesh vetëm për t'u rehabilituar, ne nuk kemi një qendër të mirëfilltë rehabilitimi. Kjo nuk do të thotë se mungon cikli i shërbimit dhe i trajtimit, pavarësisht se nuk kemi një qendër të tillë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E mbulon ambulatori i spitalit me fizioterapeutët dhe logopedistët që kemi. Nga ana tjetër, dua të jap një përgjigje për shqetësimin që u ngrit në lidhje me depistimin neonatal në Universitetin e Mjekësisë. Ne jemi të gatshëm që, brenda shpenzimeve operative, spitalet që e kanë këtë projekt ta vazhdojnë, sepse aty kërkohet vetëm identifikimi i stafit mjekësor dhe infermieror. Pra, nëse një infermier është i mirëtrajnuar, ai mund ta vendoset në dispozicion të këtij depistimi. Gjithashtu, edhe shpenzimet operative për aparaturat janë brenda paketës “602” të spitaleve, kështu që nuk shikoj se ka...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, për t'ju shpjeguar: buxhetet e spitaleve janë buxhete totale, kurse zërat e shpenzimeve përcaktohen nga vetë spitalet. Ne i kemi të gjitha të decentralizuara, sepse ministria nuk bën zëra për shpenzimet, ndaj gaboheni kur mendoni se fajin e ka ministra nëse

mungon ndonjë gjë në spital. Në fakt, ministra ka faj nëse nuk e buxheton. Ne brenda “602” – it që u japim spitaleve, pra shpenzimeve operative, ata mund ta miradministrojnë buxhetin në funksion të projekteve që kanë. Unë e di shumë mirë se këto kosto nuk janë të mëdha dhe janë bërë dy projekte për depistimin neonatal, por këto kosto janë të mëdha krahasuar me buxhetet që ato kanë, pasi janë shumë të pranueshme, duke përjashtuar spitalin e Durrësit, që ka bordin e tij dhe mund ta përcaktojë vetë shumën e buxhetit, kurse për pjesën tjetër, nëse ata kërkojnë një konfirmim, ne jemi të gatshëm t’i mbështesim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë jam dakord me urdhrat nga sipër, por depistimi i detyrueshëm ka lidhje me një program të qëndrueshëm. Unë jam shumë dakord dhe ky është një projekt shumë i mirë, por ne nuk kemi sot një raport të këtij projekti për ta kthyer në një program të mirëfilltë kombëtar. Ne nuk mundemi të buxhetojmë pa pasur një program kombëtar, ndaj le ta bëjmë programin kombëtar. Unë jam e gatshme që të angazhohemi këtë vit, bashkë me Institutin e Shëndetit Publik, bashkë me spitalet, dhe të bëjmë strategjinë, të bëjmë një program kombëtar, ashtu siç e bëmë për testin e HPV-së të qafës së mitrës. Ne këtë e bëmë me vendim qeverie dhe e futëm në program kombëtar, njëllor siç do ta bëjmë edhe për kancerin e gjirit vitin e ardhshëm. Pra, le të bëjmë edhe për depistimin e hershëm, por ta bëjmë si program, sepse nëse fillojmë të financojmë Durrësin, të financojmë këtë apo të financojmë atë, atëherë ky do të kthehet si të gjitha programet e tjera dhe një ditë të bukur do të zhduket, sepse nuk do të jemi më ne këtu. Pra, do të themi që u bë njëherë, por u la përgjysmë, siç kanë ndodhur shumë histori këtu, që janë bërë një herë transplante dhe më pas janë harruar, pasi edhe fondet, edhe kujtesa, nuk janë më, ndaj harrohen edhe ato çfarë janë bërë.

Nuk dua të zgjatem shumë, por mund të them se në fokus të politikave tona është pjesa e shëndetit riprodhues brenda qendrave shëndetësore. Unë besoj se 413 punonjësit socialë dhe psikologët do të jenë një vlerë e shtuar në qendrat shëndetësore për sa i përket çështjes së trajtimit të të rinjve.

Lidhur me godinën 6-katëshe kemi një projekt për atë godinë, besoj se jua ka thënë edhe rektori i mjekësisë, pasi bashkë po e bëjmë. Godina 6-katëshe, në momentin që do të përfundojë spitali i ri, do të shembet dhe në atë hapësirë ne do të ndërtojmë qendrën e biostimulimit klinik dhe të edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë. Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të “Paktit për universitetin” ka vënë 6,5 milionë lekë brenda buxhetit të këtij viti dhe ne jemi duke hartuar projektin që do të ndërtohet në QSUT, pra në të njëjtin ambient që sot është 6-katëshi. Prandaj, unë reagoja dhe doja t’ju ktheja përgjigje, sepse bashkë me universitetin jemi në diskutime për të ndërtuar diçka të re.

6-katëshi është një godinë e ezauruar dhe mund të merret përsipër për t'u rehabilituar. Kur ne bëmë vlerësimin me ekspertët e Bankës së Këshillit të Europës, të cilët dhanë kredinë, na u tha se duhet të ndërtojmë një spital të ri, pasi rehabilitimi i 6-katëshi do të na kushtonte dyfish. Ky spital është amortizuar aq shumë, sa që e ka humbur vlerën që ka pasur, kështu që i ka ardhur ora ndërtimit të një qendre të biostimulimit klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë. Kjo po bëhet me fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sepse jeni në dijeni që çdo fond që shkon për ta, është për 10-vjeçarin e ardhshëm, por janë para që i shkojnë shëndetësisë.

Për sa i përket qendrës për të verbrit, dua t'ju them diçka, të cilën, ndoshta, do t'ua thoni grupeve të interesit, kur të vijë momenti, që ne kemi ngritur mekanizmin e fondit social. Edhe një herë: bashkitë që duan të ngrenë shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuar, ku do të futen edhe ata me status të verbër, duhet të aplikojnë në mënyrë që të përfitojnë fonde dhe të kryejnë shërbime. Ministra e Shëndetësisë nuk mund të mbështesë shoqatat, të cilat duan fonde për të mbajtur stafin në punë. Jo, sepse ne ofrojmë shërbime.

Për shembull, këto bashki duhet të aplikojnë në Bashkinë e Tiranës, nëse janë brenda strukturës për shërbime lokale, që të përfitojnë fonde për shërbimet që duhen për personat me statusin e të verbrit. Duhet të jemi realistë që ne nuk mund të ndërtojmë qendra për shërbime kombëtare. Çfarë shërbimi mund t'i ofrosh një personi me aftësi të kufizuar, i cili do të vijë nga Kukësi në Tiranë? Ne duam ta çojmë shërbimin afër njerëzve, jo të sjellim njerëzit afër shërbimit. Me çfarë makine, me çfarë autobusi do të vijë ky njeri në Tiranë? Apo hajde t'u japim këtyre qendrave kombëtare 60 milionë lekë që ata të mbajnë disa njerëz në punë, se patjetër që do të paguhen, por ne duhet të dimë se çfarë shërbimesh do të ofrojnë. Ne jemi të gatshëm t'i mbështesim nëpërmjet fondit social, të aplikojnë në Bashkinë e Tiranës, nëse janë në Tiranë apo në Bashkinë e Kavajës, nëse janë në Kavajë, apo në Bashkinë e Elbasanit, të na sjellin numrin e përfituesve, të na sjellin shërbimet që ofrohen, të na sjellin të gjitha të dhënat dhe hajdeni ta financojmë me përqindje. Pra, herën e parë ne financojmë nën 80%, sepse këtu futet në lojë edhe bashkia, pasi edhe bashkia, duke kaluar këtu te pyetja e Adelinës, duhet të marrë përgjegjësi. Vërtet mbështet qendra "Horizont", por le të aplikojë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, duhet mbështetur nga bashkia dhe mund të aplikojë për të rritur shërbimet te ne si ministri për fondin social, por ne nuk mund të presim që shërbimet lokale të mbështeten vetëm nga buxheti i ministrisë. Më besoni, bashkitë duhet të marrin përgjegjësi që të ndërtojnë qendra shërbimesh.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zonja Adelina, le të hapë një shërbim tjetër dhe ne e financojmë, por, përderisa ky është një shërbim i ngritur, është gjynah që t'u japim para. Ata le ta zgjerojnë gamën e shërbimeve dhe ne u japim paratë.

Kam edhe një përgjigje për dy pyetjet e bëra nga deputetët.

A mund të përgjigjem?

**Enver Roshi** – Po, por shkurt ose mund t'i dërgosh me shkrim.

**Ogerta Manstirliu** – Plani i GDP-së për vitin 2019 është 2,94, kurse për vitin 2020 planifikohet 2,99; PAK-u për vitin 2019 është 15,4; për vitin 2020 planifikohet 16,6. Më shkurt se kaq, nuk kam çfarë të them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sigurisht, kemi nevojë për më shumë. Për çështjen e largimit të mjekëve, mund të them se në fillim të patronazhit kemi pasur 28 mijë mjekë, kurse sot kemi 6 mjekë dhe rreth 130 mjekë që i kanë plotësuar specializimet.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Enver Roshi** – Zonja Ministre, për lindjen e fëmijëve neonatë është një projekt pilot që i ka të gjitha pajisjet, ndaj mos ua lini shpenzimeve operative.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Programi i strategjisë do të bëhet pas kësaj, por ky është program pilot dhe pajisjet shkojnë atje, njerëzit shkojnë atje, ndaj bëni shërbime depistimi të detyruara dhe mos ua lini spitaleve, por futini në buxhet.

Atëherë, e kalojmë buxhetin në parim me sugjerimet dhe vërejtjet tona.

Miratohet.

## **MBYLLET MBLEDHJA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 18.11.2019, ora 14:00

**Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me ministren e Financave dhe Ekonomisë.

**Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Selami Jenishehri, Roland Xhelilaj dhe Eugen Bojaxhiu.

**Mungojnë:**

Klotilda Bushka dhe Almira Xhembulla

**Të ftuar:**

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Dajna Sorense - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhembë – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani – Drejtoreshë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elira Demiraj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit



## HAPET MBLEDHJA

**Enver Roshi** – Të ftuar kemi: ministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Anila Denaj, zonjën Mimoza Dhambi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, e cila nuk ka ardhur.

Zonjën Genta Prodani, drejtoreshë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, zonjën Elira Demiraj, drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar e Punësimit dhe zonjën Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Urdhëroni!

**Anila Denaj** – Përshëndetje!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, projektbuxheti i vitit 2020 vjen me disa angazhime, mbi të gjitha, me angazhimin e qeverisë shqiptare për vijuar reformat, të cilat nxisin: ekonominë, punësimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por, mbi të gjitha, vijnë angazhimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të ruajtur kuadrin makroekonomik të kujdesshëm, realist dhe një konsolidim fiskal, i cili vjen në vazhdim të politikave të viteve të shkuara për të mbështetur financa publike të forta, stabilitet financiar dhe një qëndrueshmëri të buxhetit afatmesëm.

Konkretisht në terma politikë, makroekonomikë dhe fiskalë, ky buxhet synon:

Së pari, një rritjeje ekonomike, e cila parashikohet të jetë në nivelin 4,1% në vitin 2020, kryesisht kjo e gjeneruar nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi, ashtu edhe investimet dhe me objektivitetin për të krijuar rreth 35 mijë vende të reja pune dhe uljen e papunësisë poshtë nivelit 11,5% të regjistruar në fund të këtij 6-mujori.

Gjithashtu, siguron një ritëm të investimeve publike në nivelin 4,5% të produktit të brendshëm bruto në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit; ruajtjen e balancës primare pozitive për të pestin vit radhazi në nivelin 0,7% ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2020, një borxh të reduktuar, si pjesë e angazhimeve të politikës makroekonomike, për ta çuar në vitin 2021 në 59% dhe në vitin 2022 në 57%, sikurse dhe mbajtjen e deficitit buxhetor, i cili për vitin koherent synohet të jetë 1,9%, siç është objektivizuar dhe më tej të planifikohet në ulje në 1,6% në vitin 2020.

Sigurisht, parashikimi i të ardhurave është parashikimi bazë mbi të cilën parashikohet e gjithë mbështetja buxhetore e sektorëve prioritarë të ekonomisë, por dua të theksoj se projeksiioni i vitit 2020, përtej ritmit të rritjes ekonomike, që e thashë pak më parë në 4,1% e mbështesim edhe në rezultate paraprake fiskale, të cilat në fund të vitit 2019 do të jenë të rishikuara me një mungesë të ardhurash prej 1,8% në krahasim me planin paraardhës.

Sigurisht, ne jemi të angazhuar që kjo ulje nga parashikimi, e cila është argumentuar dhe mund të argumentohet edhe me shkrim në kontekstin e kërkesës nga ana juaj, e kemi

argumentuar edhe në Komisionin e Ekonomisë kur i kemi parë, zë më zë, në mënyrë absolute nuk cenon kuadrin makroekonomik fiskal.

Së pari, sepse ka elemente amortizuese në buxhet, të cilat i kemi ruajtur, sikurse kemi marrë masa për të ngrirë disa investime deri në fund të vitit për të parashikuar që kjo ulje, e cila vjen e argumentuar nga parashikimi të mos cenojë konsolidimin fiskal.

Për sa i përket vitit 2020, të ardhurat totale janë parashikuar me rritje, por siç e thashë edhe më parë mbi bazë të vitit 2019, që fillon në vlerë absolute nga një shifër prej 474 miliardë lekësh ose 24 miliardë lekë më shumë se viti 2018. Në vitin 2020 parashikohet një rritje me 29,2 miliardë lekë më shumë nga kjo bazë që përmenda pak më parë dhe synon që buxheti të rritet me 6,2% në nivelin e të ardhurave nga i pritshmi i vitit 2019.

Për sa u përket shpenzimeve buxhetore, ato parashikohen në nivelin e 532 miliardë lekëve në vitin 2020 ose 29,7% e produktit të brendshëm bruto. Këto tregues janë në rritej me 5,1%, në krahasim me një vit më parë.

Cilat janë prioritetet kryesore të mbështetura nga buxheti i vitit 2020?

Më poshtë po i listoj sipas vlerës në rritje për kontribut në vlerë absolute duke filluar nga arsimi, të cilit i alokohen 3,3 miliardë lekë më shumë se buxheti i vitit 2019. Më lejoni të theksoj se edhe në vitin 2019 arsimi mori një fond të konsiderueshëm, si rezultat i marrëdhënies....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendova se një kuadër makro do të duhej.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lejoni ta mbaroj që të vijmë te strehimi e me radhë. Mendoj se çdo komision meriton të ketë një informacion të përgjithshëm. Unë e kam reduktuar të gjithë prezantimin në elementet kyçe. Sa janë të ardhurat totale? Nga se vjen? Cila është rritja ekonomike? Cili është zëri i buxhetit? Deri tani këto ishin shifrat.

Në mënyrë të sintetizuar, arsimi merr 3,3% miliardë lekë më shumë, shëndetësia merr 2,75% miliardë lekë më shumë, bujqësia merr 1,8% miliardë lekë më shumë se viti 2019, edhe mbrojtja si rezultat i angazhimit në NATO.

Konkretisht, në raport me financimin për strehimin, po e filloj te pjesa që është më me interes për këtë komision. Në programin buxhetor të strehimit për vitin 2020 janë parashikuar 630 milionë lekë, 100 milionë lekë më pak se fondet e vitit 2019. Fillimisht me vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, tavanet buxhetore të planifikuara në programin e strehimit social ishin 380 milionë lekë në zërin e subvencioneve dhe 250 milionë lekë për projektet e investimeve. Nisur nga rënia e normave të interesit të bonove të thesarit, që pati ndikim të dukshëm në rënie e kërkesës për subvencione për interesat e kredive për vitin 2019, trend i cili parashikohet të vijojë edhe këtë vit që vjen, si dhe kërkesat e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbështetje nga buxheti i shtetit për projektet e investimeve që adresojnë shtresat më në nevojë, u kërkua që të bëhet një rialokim i fondeve nga artikulli i subvencionit në artikullin e investimeve në vlerën 71 milionë lekë. Kështu që për programin buxhetor të strehimit për vitin 2020 janë planifikuar 309 milionë lekë në zërin subvencione

për interesat e kredive ekzistuese dhe të reja, subvencion për qira dhe grant të menjëhershëm ndërsa 321 milionë lekë janë planifikuar për investime për programet e përmirësimit të kushteve të banimit, për komunitetet të pafavorizuara dhe për rikonstruksionin e godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes qendrore për t'i kthyer në banesa sociale. Nga fondi i planifikuar i investimeve prej 321 milionë lekësh, rreth 38% janë planifikuar t'u alokohen bashkive për përfundimin e projekteve të investimit që kanë nisur gjatë vitit 2019, ndërsa pjesa tjetër e fondeve prej 198 milionë lekë, do të shërbejë për bashkëfinancimin e projektpropozimeve që do të paraqesin njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020.

Rreth 70% e fondeve të investimeve do të përdoren për programin e përmirësimit të kushteve të banimit, komuniteteve të varfra dhe të pafavorizuara, përfshirë edhe strehat e përkohshme. 20% e fondeve të investimeve do të përdoret për blerjen e banesave në treg nga bashkitë, ku blerja e banesa kushton më pak se ndërtimi i ri, duke shtuar kështu fondin publik të banesave sociale. Enti Kombëtar i Banesave ka planifikuar fillimin e ndërtimit të rreth 200 apartamenteve në Vlorë.

#### Politika e programit buxhetor, tregu i punës

Nxitja e mundësisë për punë të denjë dhe rritja e forcave të punës nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës, si dhe nëpërmjet përputhjes së kërkesës me ofertën për punë, ku përfshihen informacione për vende të lira pune, ndërmjetësimi për punësim, këshillimi dhe orientimi në karrierë, programet e nxitjes së punësimit janë pjesë e programit, të cilin e ndjek dhe e nxit edhe ministria jonë. Këtij programi për vitin 2020 i janë miratuar fondet në vlerën 1,7 miliardë lekë.

Prioritet për vitin 2020 janë programet e reja për nxitjen e punësimit në përputhje me ligjin e ri të aprovuar në vitin 2019, të cilat synojnë të mbështesin grupet më të cënueshme dhe punëkërkuessit e papunë të regjistruar që përfitojnë nga këto programe, shndërrimin e agjencisë kombëtare të punësimit në AKPA, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimin Profesional, e cila është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave më 10 tetor 2019; zgjerimi i mbulimit të shërbimit në zonat rurale në bashkëpunim me qeverinë lokale; profilizimi i punëkërkuessve përmes sistemit të rinovuar të informacionit të AKPA-ës dhe hartimi i planeve individuale të punësimit, si dhe harmonizimi të bashkëveprimit dhe ndërhyrjeve të AKPA-ës, Shërbimit Social Shtetëror dhe autoriteteve lokale.

#### Për sa i takon programit të ndërmjetësimit në punë

Ndërmjetësimi i zyrave të punës mundësojnë që punëkërkuessit e papunë të gjejnë punën më të mirë dhe sipas nevojave të tregut. Ky është një program që AKPA e ka në fokus dhe realizohet në mënyrë të centralizuar nëpërmjet një sistemi të ri të vendosur në përdorim dhe shpresojmë vitin që vjen të jetë në shfrytëzim.

Për vitin 2020 janë parashikuar për këtë program 297 miliona lekë dhe objektivi është realizimi i punësimit për 28 mijë punëkërkuess të papunë për t'u ndërmjetësuar për punë.

Për vitin 2019 për këtë program u miratuan 298,9 milionë lekë dhe për periudhën janar-shtator janë realizuar 23 mijë e 734 punësime nëpërmjet ndërmjetësimeve nga zyrat e punësimit në shkallë vendi, nga të cilat 50% janë femra.

Programet e nxitjes së punësimit, të cilat veprojnë drejtpërdrejt në grupin e punëkërkuessve të papunë për t'i nxitur ata në gjetjen e një punësimi afatgjatë, me qëllim

përfshirjen në këto programe, kryesisht të forcave vulnerabël. Në këtë program janë parashikuar 390 milionë lekë, duke synuar përfshirjen deri në 5 mijë punëkërkuar të papunë. Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit për vitin 2019 u miratuan 430 milionë lekë, 4 mijë e 770 punëkërkuar të papunë dhe deri në fund të vitit mendohet 4800 pjesëmarrës.

Për sa i përket programit të formimit profesional, ky synon trajnimin e punëkërkuarve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit në kurse afatshkurtra 3 deri në 9 muaj dhe profesione të kërkuara në tregun e punës.

Për vitin 2020 janë parashikuar 289,7 milionë lekë dhe janë planifikuar të trajnohen 17 mijë e 500 persona, prej të cilëve 11 mijë e 500 punëkërkuar të papunë në kurse profesionale të kërkuara në tregun e punës.

Për vitin 2019 u miratuan 274,7 milionë lekë dhe për këtë periudhë të vitit janë formuar 14 mijë e 800 e 46 punëkërkuar të papunë të dërguar nga zyrat e punësimit dhe vazhdojnë trajnimin në total 19 mijë e 589 persona.

Për sa i takon programit të pagesës të papunësisë, ky program është pjesë e politikave pasive të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetje me të ardhura të papunë në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës. Për vitin 2020 janë miratuar për këtë program 600 milionë lekë dhe planifikimi është për 3 mijë e 800 persona, të cilët do të përfitojnë nga pagesat e ardhura nga papunësia.

Për vitin 2019 ishte miratuar 540 milionë lekë dhe aktualisht janë në skemën e përfitimit të kësaj pagese 2 mijë e 493 punëkërkuar, të cilat aktualisht janë duke u ndërmjetësuar nga zyra e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

#### Investimet e zyrave të punësimit

Për vitin 2020 janë miratuar 67 milionë lekë, të cilat do të përdoren për riformatimin e sistemit informativ që përmenda pak më parë. Për vitin 2019 u miratuan 53 milionë lekë për investime në zyrat e punësimit të rikonstruara dhe të organizuara, sipas modelit të ri të shërbimit. Gjatë kësaj periudhe janë rikonstruara zyrat e punësimit në Durrës, në Berat, në Gjirokastrë dhe në Malësinë e Madhe.

#### Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore

Për vitin 2020 parashikohet në masën 137,5 miliardë lekë, ose 7,7% e produktit të brendshëm bruto, raport thuhet i njëjtë me vitin 2019, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2,52 miliardë lekësh. Duhet theksuar se kjo skemë i rëndon më pak buxhetit të shtetit, krahasuar me 5-6 vite më parë, së pari, për shkak të uljes së informalitetit në tregun e punës; dhe, së dyti, rritjes së nivelit të punësimit dhe kontribuuesve.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar rreth 44 miliardë lekë, ose 2,5% e produktit të brendshëm bruto nga rreth 42 miliardë lekë që ishin parashikuar deri në fund të vitit 2019.

#### Fondi për kompensim në vlerë të pronarëve

Në total parashikohen rreth 4,5 miliardë lekë, nga 1,9 miliardë lekë që ky fond ishte në vitin 2013. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje edhe të reformës që është ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda një periudhe 10-vjeçare, të parashikuar në ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit". Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën e 24,6 miliardë lekëve, konkretisht: shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe të personave me aftësi të kufizuar në nivelin 21 miliardë lekë; për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekë; për bonusin e lindjeve sërish është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh dhe pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë vitit 2020.

Së fundi, pavarësisht se është më pak e rëndësishme në kontekstin e targetuar për çështjet sociale dhe shëndetësinë, por shumë i rëndësishëm, sepse është pushteti vendor, buxheti i të cilit nga viti në vit po ndjek një trend rritës. Në vitin 2020 është programuar në rreth 57 miliardë lekë, ose 11,2% më i lartë se ai i vitit 2019. Kjo rritje prej 3,2 % në raport me produktin e brendshëm bruto do të krijojë një mundësi më të madhe në nivel vendor për konsolidimin e procesit të menaxhimit financiar; zbatimin e reformës administrativo-territoriale, decentralizimin fiskal dhe uljes së detyrimeve të prapambetura, të cilat nga viti në vit kanë të njëjtin trend ulës, pavarësisht se janë të akumuluar prej një periudhe më të gjatë kohore si rezultat edhe i qasjes që ka pasur pushteti vendor në vitet e mëparshme.

Lidhur me shëndetësinë, përmenda shumë pak, megjithatë dua t'i kthehem pjesës së programit, i cili në nivel total mbështetej me një rritje prej 2,75 miliardë lekësh, por e rëndësishme është se çfarë përfshihet në të. Në këtë program përfshihet rikonstrukcioni i 120 qendrave shëndetësore me një vlerë prej 350 milionë lekësh. Skema e ilaçeve të rimbursueshme ka një tavan, i cili është vendosur që vitin e kaluar, nga 10,5 në këtë vit, ne e kemi 11 miliardë lekë. Ky është një tavan, i cili ndjek ritmin vjetor të sëmundshmërisë, por si rezultat, besoj që edhe ministrja më përpara e ka argumentuar, i kursimeve të ndodhura dhe në negociimet që janë bërë krijon mundësitë për hapësirë për më shumë pacientë edhe këtë vit që vjen dhe në vitet në vijim, të paktën me 1 mijë pacientë më shumë në vit, sikurse edhe efektiviteti i shërbimit, i cili sigurohet nëpërmjet një shërbimi më cilësor, duke ulur numrin e kohës së pritjes, sidomos për ekzaminime të veçanta, të cilat nga 45 ditë, pritet që të ulen më shumë për ato që janë shërbime të rëndësishme, si rezonanca, skaneri e të tjerë.

**Enver Roshi**- Faleminderit, zonja Ministre!

Keni angazhime?

**Adelina Rista**- Kam një angazhim tjetër, por jam edhe 5 minuta këtu.

**Enver Roshi** – Fjalën e ka Adelina Rista.

**Adelina Rista** - Zonja Ministre, ju falënderoj për paraqitjen tuaj!

Faktikisht, në këtë komision ju jeni ministria që përgjigjet për arsimin profesional dhe për arsimin profesional ne kemi dëgjuar gjithmonë zëvendësministren që përgjigjet direkt për të, por sot komisioni donte t'ju dëgjonte ju për të paraqitur buxhetin për arsimin profesional. Unë ju falënderoj që ju këtu folët si ministre e Ekonomisë dhe na dhatë një rezymë të përgjithshme për të gjithë projektbuxhetin e vitit 2020 në të gjitha fushat ku ai vepron! Ju falënderoj sinqerisht për këtë!

Duke përfituar nga rezymeja e përgjithshme që na dhatë për të gjithë projektbuxhetin e vitit 2020, unë dua të bëj një kërkesë. Në aneksin 4 të projektbuxhetit, ku bëhet transferta për trajtime financiare specifike për dy bashkitë, Kukës dhe Kuçovë, janë mbështetur financiarisht qendrat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Unë jam deputete e qarkut Fier dhe atje ka një qendër për fëmijët me aftësi të kufizuara, e cila ka 90 fëmijë dhe nuk përgjigjet vetëm për Bashkinë e Fierit, por edhe për bashkitë fqinje, siç është Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec. Kjo është një qendër që sa vjen dhe zgjerohet, sot ka vetëm 18 punonjës socialë, duke përjashtuar punonjësit e tjerë ndihmës, është një qendër që ka kërkesa, por që Bashkia Fier, me fondet që ajo parashikon, nuk ka mundësi t'u përgjigjet të gjithë kërkesave për trajtimin ditor të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Unë kam një kërkesë nga Bashkia Fier dhe si deputete e këtij qarku e paraqita edhe para ministres së Shëndetësisë dhe përfitoj nga rasti që ta paraqes edhe para jush, për t'u mbështetur financiarisht, nga transferta për mbrojtjen sociale që u kalon bashkive, qendra e fëmijëve me aftësi të kufizuara "Horizont" dhe të përfshihet edhe Bashkia Fier te kjo mbështetje financiare për këtë qendër. Faktikisht historia e kësaj qendre ka filluar më 22 tetor të vitit 2014, është një projekt i përbashkët IADSA me Bashkinë Fier, 50 % me 50 % dhe ky bashkëpunim zgjati dy vjet dhe, pas dy vjetësh, më 22 tetor të 2016-ës, kjo qendër i kaloi komplet Bashkisë Fier. Bashkia Fier e ka mbajtur me forcat e saj me buxhetin e saj, por kjo qendër sa vjen dhe zgjerohet. Kjo qendër ose duhet të reduktojë numrin, që bie ndesh me kërkesat e qytetarëve dhe me politikat tona për mbrojtjen sociale, ose duhet mbështetur financiarisht.

Unë ju falënderoj për ndihmesën tuaj dhe për dëgjuesin!

**Anila Denaj-** Këtë kërkesë na e ka bërë në Komisionin e Ekonomisë edhe zonja Antoneta Dhima, deputete e të njëjtit qark, dhe ne e kemi marrë shënim këtë kërkesë. Edhe sot u bë një kërkesë e tillë nga një koleg në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese për të njëjtën qendër në qytetin e Lushnjës. Ne sigurisht që do ta analizojmë këtë kërkesë, por do ta shikojmë si një element ekstra, pasi, kur i financojmë politikat, duhet t'i shikojmë më afatmesme dhe afatgjata, pavarësisht nga programi IACA apo projektprogramet e tjera, në mënyrë që të mendojmë se çfarë do të ndodhë pasi të mbarojë ky fond. Kjo duhet të jetë në programet buxhetore të bashkive apo pushtetit vendor. E thashë këtë, në mënyrë që të jeni të ndërgjegjshëm se ne i kemi marrë shënim të dyja.

Ju kërkoj ndjesë për ndërhyrjen!

**Ilir Pendavinji-** Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, kryetar!

Në fakt, dua të bëj disa pyetje për një shqetësim të përgjithshëm që ekziston në të gjithë Shqipërinë, për ikjen e të rinjve jashtë vendit për t'u punësuar. Nxitja e punësimit, pagesa e papunësisë dhe ulja e pagesës për strehimin nuk i kuptoj. Sa do të jetë pagesa e papunësisë në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019? Ndoshta ju e keni thënë, por nuk arrita ta kapja.

Për programin e nxitjes së punësimit, që ne duhet ta kemi prioritet, është thënë që do të nxitim punësimin duke hapur 35 mijë vende pune, sa është buxheti për këtë pikë?

Pyeta tjetër, e cila lidhet me strehimin, me sa di unë e kemi ulur me 100 milionë.

Lidhur me nxitjen e punësimit të shtresave të marginalizuara, ose vajzave dhe grave, të cilat janë pjesa më madhe e të papunëve që kemi në Shqipëri, nuk dëgjova asgjë.

**Ervis Meço** – Faleminderit, zonja Ministre, që erdhët!

Duke pasur parasysh që jeni edhe ministria përkatëse dhe përgjegjëse për arsimin profesional, dua të di sa është ky fond për vitin 2020 dhe sa prej këtyre të rinjve, të cilët kanë mbaruar arsimin profesional, sidomos në qendrën e arsimit profesional, janë rikthyer në tregun e punës?

Së dyti, ne kemi pasur një dëgjese me zëvendësministren për sa i përket subvencionimit dhe marrjes parasysh për investimet ose për pjesën e suportit ekonomik që i jep Ministria e Financës të rinjve, të cilët duan të hapin bizneset e tyre. Deri ku ka arritur ku projekt dhe a do të fillojë në vitin 2020, apo është një projekt që mund ta tejkalojë këtë projektbuxhet?

Faleminderit!

**Edlira Bode** - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Bashkëngjitur pyetjes që bëri kolegu Pendavinji, unë i kam të listuara programet e nxitjes së punësimit si tituj, a do të ishte me interes që ne të shikonim konkretisht se çfarë përmbajnë dhe si realizohen këto programe dhe pastaj sa janë realizuar në vitin 2019 dhe sa parashikohet të realizohen në vitin 2020? Ndoshta kjo nuk është e mundur në këtë seancë dëgjimore, por a ekziston një mundësi që ne t'i kemi diku që t'i shohim dhe t'i lexojmë këto programe?

Kam një problem social. Një zonjë, kryetare e një shoqate të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Korçë, më flet vazhdimisht për të rregulluar mundësinë e transportit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin shkollat publike. Unë nuk e di nëse mund të gjendet një zgjidhje midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Arsimit, por a mund të ndërhyri ju dhe të gjeni një zgjidhje, jo vetëm për qarkun e Korçës, por për të gjithë Shqipërinë? Nëse ne kemi fëmijë me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për transport për të shkuar në shkollë, në mënyrë që ta ndjekin si të gjithë fëmijë e tjerë dhe të mos kenë nevojë për shkolla speciale, a i ndihmojmë dot familjarët me transportin për këta fëmijë?

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Në mbledhjen e mëparshme u ngrit problemi i depistimit të fëmijëve të porsalindur për dëgjimin. Është një projekt i Komunitetit European, që është 800 mijë euro, dhe kap qytetet e Kukësit, Tiranës dhe Pogradecit, i cili synon që këto pajisje që janë në këto spitale, të mbesin aty dhe duhet një fond i alokuar, në mënyrë që depistimi të jetë i detyrueshëm dhe të jetë zë i veçantë. Ministria e Shëndetësisë tha që kjo bëhet me shpenzime operative, por shqetësimi ynë është se po t'u lëmë dorë të lirë shpenzimeve operative, ata asnjëherë nuk mbërrijnë aty ku duhet. Ne duam që bebet e porsalindura të depistohen për dëgjimin dhe më vonë të hartohet një strategji kombëtare për të hapur këtë në të gjitha rrethet. Shqetësimi ynë është që po ta lëmë si shpenzime operative, këto nuk arrijnë aty ku duhet dhe duhet përsëri negociim me spitalet, drejtoritë e të tjerë. Prandaj duam që ky të jetë zë i veçantë aty për depistimin neonatal të fëmijëve, të bebeve të porsalindura për dëgjimin. Kjo është një

kosto rreth 50 milionë lekë të vjetër, por duhet të futet si projekt pilot me synimin që të bëhet strategji kombëtare. Edlira është mjeke dhe e ka shumë familjare...

**Ilir Pendavinji-** Kam edhe diçka tjetër, sepse më doli nga mendja. Paraprakisht dua t'ju falënderoj për pjesën e ndërtimit të banesave për të pastrehët në Maliq. E kam ekskluzivisht për Maliqin, sepse jam deputet i Maliqit dhe i Korçës dhe dua t'ju falënderoj, por në relacionin tuaj thoni 200 apartamente në Vlorë, Kukës, Maliq dhe Has. Sa janë sipas bashkive, në qoftë se është ky informacion?

Faleminderit!

**Anila Denaj-** Po e nis fjalën time nga shqetësimi që ngritët ju, që e keni adresuar edhe para pak javësh, të cilin e kam adresuar me buxhetin dhe do ta adresojmë në mënyrë specifike jashtë kontekstit të shpenzimeve operative. Kështu që konsiderojeni të adresuar dhe të zgjidhur. Konkretisht do të jetë një protokoll formal, por kemi rënë dakord që këtë do ta mbështesim.

Në raport me 3 elementet, të cilët unë, duke ju kërkuar shumë ndjesë, do t'i shikoj në nivelin makro, por jam e bindur që zonja zëvendësministre do t'i paraqesë në detaje, së pari, është raporti i nxitjes së punësimit në të dyja aspektet, si në raportin procedural dhe enternal, ashtu edhe për të eliminuar ikjen e të rinjve jashtë. Ne, faktikisht, konstatojmë në zyrat e punës, të cilat kanë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme jo vetëm aspektin e lokacioneve, por edhe të shërbimit, që nga një qytet në tjetrin ka diferenca të ndryshme të nevojave dhe kërkesës për fuqi punëtore, nëse mund ta themi kështu. Marr shembull rastin e Beratit, ku ne në mënyrë të vazhdueshme kemi problematika me biznesin, sepse nuk sigurojmë në kohë punonjës, të cilat, përtej faktit nëse do të jenë të trajnuar me kurset tona profesionale apo të vetë biznesit, nuk arrijnë të penetrojnë tregun e punës. Kjo lëvizje e brendshme demografike është një problem përpara se të flasim për lëvizjet demografike jashtë vendit, pasi sot ka qytete, të cilët kanë potencial zhvillimi ekonomik, kanë investitorë të huaj, që brenda projekteve të tyre për punësim kanë obligacion kontraktual dhe e kanë të pamundur që ta plotësojnë këtë obligacion kontraktual. Ngelem prapë te Berati, sepse është një rast tipik i një qyteti që ka handikapi më të madh të punësimit, edhe pse është shumë afër Tiranës dhe mundësitë e punësimit janë aty, si rezultat i lëvizjes demografike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka. Berati është një rast tipik dhe sigurisht që ne po flasim për një forcë aktive pune, e cila, së pari, do të jetë në moshën dhe, e dyta, të jetë (dhe këtu nuk ka diferencë gjiniae)... Besojmë që (edhe në një nga elementet që unë përmenda në relacion), sigurisht, një kontribut shumë i madh ka qenë edhe nxitja e punësimit të gjinisë femërore dhe kjo është parë e rritur nga një vit në tjetrin.

Ikja e të rinjve duhet të konsiderohet si një problem i brendshëm nga njëri qytet tek tjetri, përpara se të flasim për nivelin e nxitjes së punësimit në nivel më makro se cilat do të ishin disa politika se si mund të frenohej kjo ikje. Ky është një problem që ne e konstatojmë në përditshmërinë tonë dhe që nuk ka të bëjë me sigurimin e një shërbimi në kohë nga zyrat e punës, as të një trajtimi profesional të kurseve që ne ofrojmë, edhe pse këtu mund të jetë i drejtë shqetësimi se nuk ka një qendër të mirëfilltë të arsimit profesional. Por nuk mendojmë se ky ka qenë ngërçi kryesor.



Për sa i përket elementit të dytë për nxitjen e punësimit, që ju e përmendët pak më parë, që ka të bëjë me sa fonde dedikohen, unë mund të them se, po, në raport me shifrat që unë përmenda, po flasim për një vit të programit të zgjidhjes së punësimit me 100 milionë lekë më pak në vitin 2020 nga viti 2019. Kjo, sigurisht, nuk do të synonte, le të themi, cenimin e efektivitetit në kontekstin e përfshirjes së punëkërkuësve në numër, edhe pse gjykojmë se kjo është një tkurrje temporale dhe jo afatmesme, për arsyt e brendshme të rialokimit të fondeve. Jemi shumë shpresëplotë që të paktën brenda vitit të kemi mundësi ta çojmë në të njëjtin nivel si viti 2020. Ndërkohë, për sa i përket programit të formimit profesional, të gjitha fondet janë në tregues më rritës sesa viti 2019.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në vijim, i vetmi element i fundit për ligjin e punësimit, besoj për detajet do ta marrë fjalën zonja Sorensen, ne kemi miratuar në maj të këtij viti një ligj, i cili, sigurisht, ende nuk ka përfunduar me aktet nënligjore dhe me të gjitha institucionet, të cilat do ta bëjnë këtë ligj funksional, por, në thelb, objektivi bazë i projektligjit ishte nxitja e punësimit dhe shkëputja e personave me aftësi të kufizuar nga një kategori, ndaj së cilës mbështetja sociale ka qenë ose jo e vetmja alternativë e punësimit aktiv, pasi besojmë që është e vetmja mënyrë për ta nxitur tregun e punës dhe, njëherazi, për të ndryshuar një mentalitet, le ta pranojmë, prej kohësh. Besoj se ky komision, le të themi, e merr si patentë të tijën këtë element. Sigurisht, komentet e biznesit janë aty, por ne nuk na pengojnë për ta vazhduar më tej. Besojmë që vitin tjetër do të kemi më shumë persona me aftësi të kufizuar në forcat e punës.

Për më tej me shifrat...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enver Roshi** – Edlira, do të na e shpjegojnë marrëveshjen që kemi bërë me OSBE-në për të vizituar qarkun e Elbasanit dhe të Korçës, por në fund fare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të votojmë edhe në parim, por pastaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve nga zonja Sorensen.

**Dajna Sorensen** – Në rregull.

Po filloj me arsimin profesional, për të kaluar në vijim te programet e nxitjes së punësimit, duke adresuar ato pyetje, të cilat jo domosdoshmërisht morën përgjigje. Reforma e arsimit profesional në Shqipëri është e fokusuar, në radhë të parë, në rritjen e cilësisë dhe të ofertës së arsimit profesional.

Sfidat kryesore që kemi janë dy.

E para, t'u përgjigjemi nevojave të tregut të punës, nevojave të bizneseve për forcë pune të kualifikuar.

E dyta, për t'u bërë partnerë me sektorin privat në ofertën e arsimit dhe të formimit profesional.

Bashkëpunimi i deritanishëm me sektorin privat ka sjellë disa rezultate pozitive. Megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë, për të unifikuar mënyrën se si shkollat dhe institucionet e tjera të formimit profesional dialogojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me sektorin privat. Kuptohet, e gjithë veprimtaria jonë, që bëhet si në fushën e punësimit, ashtu edhe në fushën e arsimit dhe të formimit profesional, bazohet në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive 2014-2020. Në tetor të këtij viti e shtymë këtë Strategji deri në vitin 2022 dhe, kuptohet, zgjeruam kështu gamën e masave të parashikuara në kuadër të kësaj strategjie.

Pikëpyetja tipike për arsimin profesional është: “A garanton arsimi profesional punësim më të mirë për ata të cilët janë të diplomuar?”, që ishte edhe një nga pyetjet që lindi nga kolegët tuaj pak më parë. Aktualisht, sipas të dhënave të INSTAT-it unë do t’i referohem publikimit të përvitshëm të INSTAT-it “Shqipëria në shifra”, ku krahasohet shkalla e punësimit të atyre që diplomohen nga shkollat e mesme me të atyre që diplomohen në shkollat e mesme profesionale, konkretisht, shkalla e punësimit të atyre që mbarojnë arsimin e mesëm profesional është 68,3%, krahasuar me 53% për ata që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm. Dukshëm, ata të cilët diplomohen pranë institucioneve të arsimit profesional, janë më të punësueshëm, sepse kanë aftësitë e duhura, por, gjithashtu, janë më të punësueshëm, sepse kanë eksperiencat e para në vendin e punës. Është shumë ndryshe ta marrësh eksperiencën e parë në moshën 16-vjeçare, krahasuar me dikë që e merr eksperiencën e parë në moshën 22-vjeçare ose 23-vjeçare. Ky është një tjetër avantazh i arsimit dhe i formimit profesional.

Ndër vite numri i nxënësve në arsimin profesional ka qenë në rritje. Aktualisht, ky numër është 18,200. Ndoshta rritja nuk është nominale, por ka rëndësi që është në përqindje. Pra, në mënyrë të vazhdueshme përqindja e atyre që ndjekin arsimin e mesëm profesional ka qenë gjithmonë e më tepër në rritje.

Është shumë e rëndësishme të theksoj edhe faktin se ka një rritje të pjesëmarrjes së atyre që janë nga grupet vulnerable. Kemi një rritje të personave që vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, sikurse kemi një rritje të numrit të personave që janë nga zonat rurale, sikurse edhe numrit të vajzave. Një element shumë i rëndësishëm ka qenë, gjithashtu, futja e bursave për vajzat, të cilat ndjekin profile jo tipikisht për vajza, si një mënyrë për të stimuluar numrin e vajzave që ndjekin arsimin e mesëm profesional.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Absolutisht, edhe vitin e kaluar. Këto janë në parim se çfarë ka ndodhur në vijimësi. Unë e përmenda pak më parë se prioritet për ne është rritja e cilësisë së arsimit profesional, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësinë e mësuesve dhe të instruktorëve që kemi në shkollat profesionale. Për këtë element shumë i rëndësishëm ka qenë trajnimi 21-ditor, që ne e kemi vazhduar edhe gjatë vitit 2019 për mësuesit e lëndëve profesionale që nuk vijnë nga bota didaktike, nuk e njohin botën akademike domosdoshmërisht. Pra, për ta është e domosdoshme të kenë një trajnim të dedikuar prej 21 ditësh për pjesën pedagogjike, që është ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2016, duke e konkluduar në vitin 2019 me trajnimin e 120 mijë mësuesve dhe instruktorëve. Në vijim, është shumë e rëndësishme të thuhet se ky si funksion do të kryhet nga Agjencia Kombëtare për Arsim dhe Formim Profesional dhe Kualifikimet.

Për sa i pjesës cilësore, *content*-it ose përmbajtjes së arsimit profesional, këtë vit janë zhvilluar 13 përshkrime dhe standarde të kualifikimit profesional; 6 kornizë kurrikula, sikurse Agjencia po punon aktualisht për zhvillimin e dy kualifikimeve tërësisht të reja, që kanë të bëjnë me programimin dhe me teknologjitë bujqësore; nevoja këto të ardhura, kuptohet, të artikuluar nga sektori privat. Fokus të veçantë ka të nxënit nëpërmjet punës, ku përfshihet pjesa e praktikës që ndodh në biznes, sikurse një fokus i veçantë është edhe dixhitalizimi i arsimit dhe i formimit profesional.

Këto ishin disa nga elementet.

Tani, për sa i përket konkretisht projektbuxhetit për vitin 2020, unë do të doja të nënvizoja faktin se fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020 për arsimin profesional janë rritur shumë pak, me rreth 1%. Aktualisht, përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 8%, krahasuar me 6% që ka qenë më parë. Buxheti i arsimit profesional është 0,18% i gjithë buxheti dhe, siç e përmenda, është në vlerën gati 3,3 miliardë.

Shpenzimet korrente që janë planifikuar, janë rritur dhe në total shkojnë në vlerën 169,5 milionë, por është planifikuar, gjithashtu, një rritje në buxhet për sa u përket bursave të nxënësve që ndjekin arsimin profesional.

Për realizimin e orëve gjithnjë ka pasur një diferencim ndërmjet mësuesve të lëndëve profesionale dhe mësuesve të lëndëve të përgjithshme, sidomos të instruktorëve, duke pasur një disnivel shumë të madh në orët e mësimdhënies që jepnin këta mësues. Kjo, në mënyrë të drejtpërdrejtë, impaktonte cilësinë e arsimit profesional. Ndaj, me një rregullore të re, me një udhëzim të ri të ministrit të Financave kemi reduktuar numrin e orëve, duke e minimizuar këtë disnivel ndërmjet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, numrin e mësuesve të arsimit të përgjithshëm e lamë ku ishte, ndërkohë që ulëm pak profesionalin për t'i afruar me njëri-tjetrin.

Në qoftë se mësuesit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mësuesit e lëndëve të përgjithshme kanë pasur 20 orë deri në 22 orë, ndërsa mësuesit e lëndëve profesionale kanë pasur deri në 30 orë në javë, gjë që është e pamundur për një mësues të zhvillojë 30 orë në një javë. Ndaj e kemi reduktuar atë në 24 orë. Për këtë kemi parashikuar 100 mësues të rinj, të cilët do të hyjnë në sistemin e arsimit dhe të formimit profesional.

Për sa i përket pjesës së shpenzimeve kapitale, janë planifikuar 525 milionë, që është një rënie e vogël, krahasuar me një vit më parë. Konkretisht, parashikohet që vetëm një shkollë e re të fillojë rikonstruksionin këtë vit (bëhet fjalë për shkollën “Nazmi Rushiti” në Dibër), ndërsa të gjitha shkollat e tjera janë ato që kanë filluar nga rikonstruksioni në vitin 2019 dhe do ta përfundojnë në vitin 2020.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Stojku** - Për procedurë, po bëni përsëri një prezantim?

**Dajna Sorensen** – Vetëm për arsimin profesional, meqenëse ju e ngritët si çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Stojku** - A mund t’i mbledhim pyetjet dhe të vazhdoni?

**Dajna Sorensen** – Në rregull, por unë e mbarova pak a shumë pjesën për arsimin profesional dhe tani do t’u kthehem pyetjeve që lindën.

**Enver Roshi** – Më falni! Meqenëse ka edhe pyetje të tjera nga kolegët, i bëjmë dhe pastaj jua jap fjalën sërish për përgjigjet.

**Dajna Sorensen** – Në rregull.

**Arben Kamami** - Zonja Zëvendësministre, faleminderit që jeni prezente!

Ju përgëzoj për të gjithë këtë ekspozë dhe për shpjegimet!

Kam dy pyetje shumë shkurt. Për vite të tëra, madje ka dalë edhe në shqyrtimin e buxheteve të tjera, kurset e formimit profesional janë mbushur nga invalidë dhe nga njerëz që merrnin pagesa nga aftësia e kufizuar, duke e shtuar buxhetin e pagesave të këtyre personave me aftësi të kufizuar. A është marrë ndonjë masë për ta ndaluar këtë, apo është ligjërisht e pamundur për ta bërë? Çfarë impakti ka pasur në buxhet? Ndoshta nuk është te ministria juaj ky impakt.

E thënë më shkoqur, personat me aftësi të kufizuar marrin një pagesë shtesë për çdo kurs që ndjekin te kurset e formimit profesional; është njëlloj sikur ndjekin shkollën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në qoftë se është hequr tani, se deri vitin e kaluar kanë marrë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, e tërheq pyetjen. Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Stojku** - Më falni, por nga referimi që ju bëtë, dëgjova që numri i mësuesve të arsimit profesional ishte 120 mijë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ah, me 100! E pra, se u çudita, më iku truri komplet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Domethënë, kemi 18 mijë nxënës të arsimit profesional, apo jo, kaq ishte shifra totale në shkallë vendi, dhe kemi 63% të punësuar nga këta. Kjo do të thotë që, krahasimisht me shifrën 53% të arsimit të përgjithshëm, që mbarojnë të mesmen e përgjithshme, i bie që në shifra aludohet sikur ata që kanë ndjekur arsimin profesional punësohen më tepër sesa ata të arsimit të përgjithshëm.

A e dini shifrën e studentëve që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm në shkallë vendi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa mund të jetë, pyes kot, për hamendje? Besoj që është mbi 100 mijë.

**Dajna Sorensen** – Nuk e kam në këtë moment, por besoj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Stojku** - Atëherë, i gjithë problemi është këtu. E dini pse jua them? Jam marrë pak me këto punë, sepse jam marrë me një shoqatë. Nuk dua të bëj me dije erudicionin tim të famshëm në këtë fushë, e njoh arsimin profesional që në vitin 2006, kur paguheshin të gjithë këta, madje paguheshin shumë mirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ishin projekte shumë të bukura, ishin në ndërmarrjet prodhuese, që jepnin vërtet mësim dhe merrnin vërtet profesion, zanat siç e themi ne, dhe bëheshin gati për tregun e punës.

E para, nëse vihet këtu, vihet me statistikë dhe kjo e fundit do të thotë: treg pune. Cila është kërkesa? Pastaj vijohet me specifikimet: sa duhet këtu, sa duhet aty dhe në bazë të kërkesave të tregut të punës, specifikisht ndërtohet një program mësimor profesional për të gjithë vendin. Sot, në këtë komision parlamentar, e dëgjoj për herë të parë shqetësimin tuaj për arsimin profesional të shqiptarëve, i cili duhet vërtet të jetë prioritet absolut.

Së pari, kjo gjë nuk është shfaqur si në medien vizive, ashtu edhe në medien e shkruar. Pra, nuk e gjejmë askund, qoftë edhe si reklamë, sepse të gjithë shqiptarëve u është futur në mendje që të shkojnë në shkollë të lartë dhe sot të gjithë kanë 3 apo 4 diploma në xhepat e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për jurisprudencë.

Këtë nuk e kam si vërejtje për ministrinë tuaj, por për të gjitha ministritë e punës që kanë qenë deri më sot, sepse tani janë bashkuar ministritë, sepse Ministra e Punës dhe e Çështjeve Sociale ka qenë gjithmonë më vete. Ndaj, do të ishte mirë, nëse keni mundësi, t'i merrni në konsideratë sugjerimet tona, pasi fillimisht ne duhet të njohim tregun e punës, për të cilin jemi interesuar dhe më pas të fillojmë plotësimin e kërkesave që kërkon ky treg.

Së dyti, ju folët për shtresat më vulnerabël, të cilat përbëjnë një përqindje të caktuar të popullatës. Shpeshherë ne jemi të fokusuar te këto projekte, në politika, në strategji zhvillimi e të tjera. Në të vërtetë këto merren më shumë në konsideratë se pjesa tjetër e popullatës dhe nuk janë vulnerabël aq sa ç'duken, të paktën nga marrja në konsideratë e të gjithë shoqërisë shqiptare. Shoqëria civile ka rreth 1200 organizata dhe të gjitha këto marrin fonde nga AMSHC-ja, të cilat do të shkojnë për këto shtresa vulnerabël si në shëndetësi, në arsim e të tjera. Pra, nuk është kaq e lehtë.

Për sa u përket arritjeve që ju thatë dhe shqetësimit tonë lidhur me personat me aftësi të kufizuara, mund të them se janë shumë persona që janë normalë, të cilët nuk gjejnë treg pune. Pra, ne duhet të ruajmë raportet e punësimit për njerëzit me aftësi të kufizuara, si dhe për ata që janë normalë. Pra, ka raporte të përcaktuara për institucionet shtetërore, por

edhe për vendet e tjera, ku një ekonomist, një drejtues, një shef sektori apo të tjerë duhet të jenë me aftësi të kufizuar vetëm që të ruajnë raportet dhe të mos bëjnë më tepër. Pse? Sepse në të vërtetë nga i gjithë ky kontingjent, që është 100% profesional dhe 100% me arsim të mesëm, ti nuk mund të punësosh dot këta që janë normalë, pra pa probleme të kufizimeve të aftësive të tyre. Kjo do të thotë se deri tani unë nuk shikoj ndonjë strategji reale, shikoj vetëm një raport klishe. Më vjen keq, por më duhet t'ju them (nuk e di nëse kjo filmohet, apo jo, sepse për mua nuk është i rëndësishëm filmimi, nuk e bëj për atë, por sepse e njoh si fushë) që të nxirrni konkluzione për tregun e punës ku janë nevojat dhe të fusni në punë të rinjtë tanë, fëmijët tanë. Nuk kanë pse të dalin të gjithë me shkollë të lartë, sepse në fund të gjithë nuk dalin njëlloj. Shumica e fëmijëve tanë, pas mbarimit të shkollës së lartë, nuk kanë aftësi për të qenë intelektualë kalibri që të sjellin risitë shkencore në Shqipëri dhe të bëhen nobelistë. Shqipëria ka nevojë për elektrikistë, për hidraulikë e të tjera. Për të gjetur 5 elektrikistë të stadiumi kombëtar ditët e fundit janë marrë me dhunë nga qytete të tjera, me 150 mijë lekë dita, vetëm e vetëm që të lidhnin telat, sepse në Tiranë nuk kishte elektrikistë dhe ndeshja mund të kishte dështuar. Këtë po jua them me siguri, pasi kisha dy muaj që kërkoja një elektrikist për shtëpinë time. A e dini se ku e kam gjetur? E kam gjetur në një fshat të Durrësit. Pra, ose bëni një raport të vërtetë, sepse e keni në dorë që ta bëni, ose mos hajdeni këtu të na lexoni raporte të përgjithshme që sipas OBSH-së ndodhi kjo, sipas OSBE-së kjo tjetra, sipas kësaj apo asaj, sepse nuk është e nevojshme, por duhet të shikoni mundësinë që të plotësoni nevojat tona. Ne jetojmë në Shqipëri dhe, në radhë të parë, duhet t'i shërbejmë vetes sonë dhe më pas të merremi me të tjerët.

Faleminderit që patët durimin të më dëgjoni!

**Dajna Sorensen** - Atëherë, po filloj me fondet e nxitjes, ashtu sikurse e përmendi edhe ministria.

Fondet e nxitjes kanë pësuar një rënie nga 490 milionë, që kanë qenë të parashikuara në vitin 2019, në 390 milionë, pra kanë pësuar një rënie me 100 milionë. Ndërsa, pagesa e papunësisë ka pësuar një rritje faktikisht nga 500 milionë, që ishte vitin e kaluar, në 600 milionë këtë vit. Mendoj se gjithmonë ka një diskutim të gjerë që ndodh...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju keni të drejtë dhe argumenti juaj qëndron, por, deri diku, ne kemi nevojë për të balancuar politikat aktive me politikat pasive. Ky mund të jetë një rekomandim i komisionit tuaj në qoftë se ju e shikoni të arsyeshme. Megjithatë, kjo ka filluar që këtë vit, sepse pati një rritje sidomos në fillim të vitit për pagesat e papunësisë, prandaj mund të ketë ndodhur edhe ky zhbalancim për të qenë të sigurt që këto fonde janë të rezervuara për këtë gjë. Në qoftë se komisioni e shikon të arsyeshme, unë mendoj se këtë propozim duhet ta sugjeroni te komisioni përkatës.

Kishte një pyetje për sa i përket përqindjes së atyre që janë të diplomuar në shkollat profesionale dhe që ndjekin arsimin e lartë në vijimësi. Ne kemi dy vjet rresht që kemi bërë gjurmimin e të gjithë nxënësve në arsimin profesional, si të atyre që u diplomuan në vitin 2017 dhe atyre që u diplomuan në vitin 2018, për të parë përqindjen se sa prej tyre futen në tregun e punës dhe sa futen në arsim të lartë.

Janë dy dokumente, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe janë të aksesueshme nga të gjithë. Ajo që dua të nënvizoj është fakti se ka një

variacion shumë të lartë nga shkolla në shkollë. Për shembull, në qoftë se marrim shkollat e IT-së ato janë shumë më të prirura për të dërguar nxënësit në arsimin e lartë. Për shembull, rreth 91% e nxënësve të shkollës së mesme profesionale “Hermann Gmeiner”, në Tiranë, kanë shkuar në arsim të lartë. Ndërkohë për profesionet që janë më afër tregut të punës dhe kërkojnë një dalje të drejtpërdrejtë në tregun e punës, siç është shkolla e Hoteli –Turizmit, aty punësohen shumë më tepër se sa ndjekin arsimin e lartë. Këta vjet kemi vënë re edhe një rritje të atyre që ndjekin programet 2-vjeçare pas shkollës së mesme, pra që përfundojnë shkollat profesionale, por që shkojnë për një nivel të ndërmjetëm që nuk është as universitet, por është një program 2-vjeçar pas përfundimit të shkollës së mesme.

Për sa i përket pyetjes lidhur me bizneset e reja, ne e kemi diskutuar edhe gjatë dëgjësës që kemi bërë bashkë, ku kemi parashikuar që një ndër programet e reja për nxitjen e punësimit, që do të zbatohet në vitin 2020, do të jetë i dedikuar për vetëpunësimin e të rinjve. Pra, të rinjtë dhe të rejat, të cilët janë të interesuar të hapin një biznes do të kenë mundësi të aplikojnë për vetëpunësim pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, siç janë programet e tjera të nxitjes së punësimit, ku është parashikuar që të marrin një grant për blerjen e pajisjeve të domosdoshme për të hapur biznesin e tyre.

Ky është një program, i cili më parë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ky program është i hapur për punëkërkuesit, të cilët duan të vetëpunësohen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, mund të jetë një rast i tillë.

E përmenda edhe më parë që programet e nxitjes së punësimit kanë qenë 8, të cilat në thelb nuk ndryshonin shumë nga njëri-tjetri. Domethënë, ka pasur një program të dedikuar për vajzat, një grant për personat me aftësi të kufizuara, një për të rinjtë e të tjera, të cilat në thelb janë të gjitha njëlloj për punësim të subvencionuar, ku biznesi që merrte përsipër të punësonte një të papunë subvencionohej për pagën e këtij personi. Tani, me ligjin e ri të nxitjes së punësimit, ne po e ndryshojmë komplet gamën e programeve. Janë dy vendime të Këshillit të Ministrave, një vendim për 3 programe dhe vendimi tjetër për një program të veçantë, si dhe për programe komplet të reja, që do të zbatohen për herë të parë në vitin 2020.

Në këtë moment këto projektvendime të Këshillit të Ministrave janë në ministritë e linjës për mendim dhe nga data 1 janar ne duhet t’i kemi gati për t’i zbatuar gjatë vitit 2020. Këto programe janë të bazuara në eksperiencat më të mira, në fokus të të cilave vendoset individi dhe jo biznesi, sepse në fund të ditës është mbështetja që ne duhet t’i japim individit. Për t’ju dhënë një shembull konkret, ndryshe trajtohet një vajzë në tregun e punës dhe ndryshe një djalë, sepse vajzat kanë më disavantazhe se sa djemtë. Për shembull, për nënat, të cilat duhet të çojnë fëmijët në kopsht ose në çerdhe, ne kemi parashikuar edhe subvencionim për kopshtin dhe për çerdhen në qoftë se është e nevojshme, si dhe kemi parashikuar kosto transporti pikërisht për t’u dhënë mundësinë atyre të kenë atë akses të njëjtë në tregun e punës, sikurse edhe burrat, ashtu sikurse kemi parashikuar edhe paketa shtesë për të mbështetur vulnerabilitetet e tjera.

Unë dua t’i kthehem vetëm një sekondë komentit të zotërisë, i cili u largua. Unë mendoj se si një shtet social që jemi, ne kemi përgjegjësi absolute për të garantuar shanse të

barabarta për të gjithë personat, të cilët janë të disavantazhuar në tregun e punës, në veçanti për personat me aftësi të kufizuar për t'i vendosur ata në kushte të barabarta dhe për t'i integruar në tregun e punës njëlloj si gjithë të tjerët, ndaj nuk jam dakord me të njëjtën qasje që bëri zotëria.

Për sa u përket problematikave që ngriti zotëria, të cilat kanë të bëjnë me shifrat e ndjekjes së arsimit profesional, unë bazohem vetëm tek të dhënat zyrtare të INSTAT-it. Në qoftë se në vitin 2013 kemi pasur vetëm 13% të atyre që ndiqnin arsimin e mesëm profesional, aktualisht kemi afërsisht 21%, që për mua është një shifër domethënëse. Tani, secili mund ta bëjë si të dojë interpretimin e shifrave, por shifrat janë shumë kokëforte dhe nuk varen nga unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në vitin 2013 nga 13% në 20,6%.

**Edmond Stojku** - I bie rreth 4 mijë veta në vit.

**Dajna Sorensen** - Jo, nuk i bie 4 mijë veta në vit. Pra, është rritur me 7,6% si në numra nominalë, ashtu edhe në përqindje, kështu që për mua është shumë e rëndësishme.

Për sa u përket kushteve të formimit profesional nuk kemi një pagesë për personat me aftësi të kufizuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër!

**Arben Kamami** - Domethënë, invalidët marrin pagesë shtesë nga sigurimet shoqërore për çdo kurs që ndjekin dhe nuk ka kufizim për numrin e kurseve?

**Dajna Sorensen** – Nuk besoj se është kështu.

**Arben Kamami** - Këtë gjë mua ma ka thënë një njëri që punon atje. Pra, problemi është se nuk ka kufizime për numrin e kurseve ku futen, sepse ata mund të bëjnë një kurs, bëjnë 3 muaj pushim dhe më pas mund të vazhdojnë përsëri të bëjnë një kurs tjetër.

**Dajna Sorensen** – Unë do ta verifikoj dhe do ta ndjek si çështje.

**Arben Kamami** - Faleminderit!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Edlira Bode** - Unë u shkëputa për disa minuta dhe ndoshta nuk e dëgjova përgjigjen, por po i rikthehem edhe një herë pyetjes lidhur me transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara për në shkollë. A është dhënë një përgjigje e tillë? Nëse po, a mund ta jemi edhe një herë, nëse mundeni?

Realisht një pjesë e mirë e të punësuarve, nëpërmjet zyrave tuaja të punës, kohëzgjatjen e kanë shumë të vogël në atë punë që ju u gjeni. A ka një rikthim të njerëzve për të kërkuar punë përsëri në zyrat e punës? A zëvendësohen këto vende pune me këta njerëz të tjerë që dërgon zyra e punës? Unë nuk e di pse ndodh kjo, por është një fenomen shumë i përhapur. Ju thoni se janë punësuar kaq vetë nga zyrat e punës, ndërkohë që keni ndërmjetësuar punësimin e 20 mijë njerëzve. A është bërë diferenca e këtyre që e lënë punën



me ata që e marrin punën apo keni një shifër totale të punësimeve, pra të kontratave të nënshkruara, ndërkohë që këto kontrata zgjatin 6 muaj?

Faleminderit!

**Dajna Sorensen** – Unë do të përgjigjem për pjesën e dytë të pyetjes dhe më pas do t'ia kaloj fjalën drejtoreshës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit për të dhënë një përgjigje të plotë.

Në radhë të parë, ne quajmë punësim çdo vend të lirë pune unik, që është në sistemin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, që lidhet me një individ unik që punësohet.

Në këtë moment jemi duke bërë dy procese shumë të rëndësishme:

Së pari, ne mbikëqyrim se sa përqind e këtyre vendeve të punës, që plotësohen nga lista e të papunëve, rezultojnë në punësim formal, është shumë i rëndësishëm.

Elementi i dytë është se sa përqind e këtyre punësimeve zgjasin më shumë se 30 ditë e kështu me radhë, për të monitoruar këtë që të sigurohemi të kemi një përqindje sa më të lartë të personave që qëndrojnë më afatgjatë në punë. Megjithatë, ajo është një marrëdhënie mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, të cilën zyra e punës nuk e afekton dot, por ama është një indikator cilësie për punën që bën zyra e punës. Ne jemi duke monitoruar këtë jo vetëm në nivel kombëtar, si shërbim punësimi, në mënyrë të vazhdueshme, por edhe për çdo zyrë, për të kuptuar nëse ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes cilësisë së ndërmjetësimit dhe qëndrueshmërisë që individi ka në vendin e punës.

Për sa i përket pjesës së transportit të fëmijëve me aftësi të kufizuar pranë institucioneve të arsimit publik, unë nuk kam një përgjigje në këtë moment, por do t'jua dërgojmë me shkrim. Elvira mund të shtojë diçka.

**Enver Roshi** – Po.

**Elvira** – Zëvendësministria e ezauroi pothuajse të gjithë çështjen. Unë jam shumë dakord me zonjën, e cila tha që ka qenë fenomen dhe ne e kemi konstatuar. Një sistem i tillë IT-je të ndihmon shumë që të lidhesh me zyrën e tatimeve që të marrësh të gjitha të dhënat në kohë reale.

Ministria përmendi që është financuar sistemi i ri i shërbimit kombëtar të punësimit, i cili do të lidhet me zyrën e tatimeve dhe ne do të kemi mundësi të marrim të dhënat e punësimit në kohë reale. Nëse biznesi e deklaron, individi deklarohet i punësuar nëse ai punon edhe një ditë. Ndërsa vlerësimi dhe analiza e qëndrueshmërisë bëhet më e qartë nëse përputhja me vendin e punës ka qenë aq e mirë sa duhet.

Ne kemi edhe probleme të aftësimin të individëve edhe me “aftësi të buta”, siç i themi ne. Ka pasur shumë nevojë që individët e regjistruar për punësim të zhvillojnë edhe disa aftësi të tjera që quhen aftësi të buta. Vetëm këtë vit ne kemi trajnuar më shumë se 13 mijë persona me *soft skills*, të cilët duhen përqendruar në tregun e punës. Kjo lidhet me disiplinimin, etikën, higjienën, kushtet e punës, e të tjera, pra ka shumë elemente, të cilat ne po i pasurojmë edhe në shërbimet e punësimit për të rritur aftësinë e këtij individi për qëndrueshmëri. Për këtë ne kemi filluar fuqishëm, ku kemi ndërtuar edhe një *call center* pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për të evidentuar rastet dhe për t'i matur këta indikatorë. Pra, të dimë se sa për qind e tyre rezultojnë të regjistruar në zyrën e tatimeve dhe

si është kohëzgjatja e tyre në punë, pra a kthehen këta individë, me qëllim që të regjistrohen në sistemin tonë dhe ne të shqyrtojmë dhe të analizojmë me detaje individin. Kjo është një punë titanike për specialistët, të cilët identifikojnë të gjitha problemet, sepse nuk janë vetëm problemet e punësimit, por ka probleme nga më të ndryshmet, si: sociale, *child care*, transport dhe për kushtet e punës në biznese, të cilat ndonjëherë janë jashtë kompetencave të shërbimeve tona. Pra, ne jemi shumë të përkushtuar që t'i evidentojmë problematikat me qëllim që t'i referojmë në sektorët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht.

**Deputete** – *(Flet pa mikrofon)* ... tek i njëjti biznes, shkojnë disa individë dhe asnjëri nuk qëndron gjatë. Si vepron në këtë rast?

**Elvira Demiraj** – Kjo është ideja, mbledhja e të dhënave dhe marrja e sinjaleve është shumë e rëndësishme për ne dhe shkon e gjitha në një linjë. Ne kemi marrëveshje me Inspektoratin e Punës, me Shërbimin Social Shtetëror dhe kemi iniciuar marrëveshje me bashkitë. Pra, të gjitha problematikat që janë jashtë shërbimeve tona të punësimit, ne i adresojmë në institucionet përkatëse. Për shembull, nëse kemi sinjalizime për subjekte të ndryshme, ne sinjalizojmë tek Inspektorati. Ne kemi marrëveshje me të gjitha zyrat e punës dhe me Drejtorinë Rajonale të Inspektoratit, ku referojmë të gjitha rastet, jo në konceptin e informacionit të dedikuar, por duke e dhënë si fenomen, si për fasoneritë dhe për çdo lloj subjekti. Kjo është detyra jonë për të informuar, pastaj janë institucionet që e marrin.

**Enver Roshi** – Po, e fundit.

**Adelina Rista** – Zonja Dajna, faleminderit për paraqitjen tuaj këtu! Ne si komision jemi të familjarizuar me ju dhe ju quajmë si pjesë jona për sa i përket fushës së arsimit profesional, që e njihni aq mirë dhe nuk përtoni të na sqaroni në detaje.

Faktikisht që në vitin 2014 kur ofruesit e arsimit dhe formimit profesional u shkëputën nga Ministria e Arsimit, Kulturës dhe e Sporteve dhe kaluan në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale atëherë dhe sot në Ministrinë e Ekonomisë, unë mund të them me plot gojë se në arsimin profesional është bërë reformë dhe reformat mbështeten me financim buxhetor. Ne sot po diskutojmë për buxhetin, i cili është me rritje dhe kjo është pozitive. Pra, gjithmonë reformat kërkojnë mbështetje financiare.

Unë do të qëndroj pak tek arsimi profesional. Faktikisht ofruesit e arsimit dhe formimit profesional kanë si qëllim orientimin drejt tregut të punës, sepse tregu është kërkuar. Nëse do të ishte këtu kolegu im, Ismeti, i Komisionit të Edukimit, do të fliste për Shkollën e Teknikumit të Naftës në Ballsh, sepse duhen specialistë naftë, Fadili për shkollën në Kuçovë, ndërsa unë flas për shkollën e mesme profesionale “Petro Sota” në Fier, ku janë hapur klasat për specialitetin e naftës.

Në Fier dy shkolla profesionale janë kthyer në identitet si të profilizuara, është shkolla mesme bujqësore “Rakip Kryeziu” dhe shkolla “Petro Sota”.

Ju folët për gjurmueshmërinë dhe kjo është pozitive, sepse ne, nëse nuk ngremë sistemin e gjurmueshmërisë, nuk e matim dot se si ka ecur, si po ecën dhe si është arsimi profesional drejt tregut të punës.

Unë dua të bëj një pyetje: sa nxënës hyjnë në vitin e parë në arsimin profesional dhe sa dalin në fund të vitit? Pra, nëse në shkolla, për shembull, hyjnë 50 dhe dalin 20 nxënës, këta 30 të tjerët ku përfundojnë? Ata shkojnë në arsimin e mesëm të përgjithshëm apo e kanë lënë shkollën fare? Pra, ky është sistemi i gjurmueshmërisë.

**Enver Roshi** – Kjo është pyetja?

**Adelina Rista** – Sa nxënës hyjnë në vitin e parë dhe sa përfundojnë? Këta nxënës që përfundojnë shkollën, sa punësohen këtu dhe sa punësohen në Zvicër dhe Gjermani? Me këto dy vende ne kemi bashkëpunim për sa u përket kurikulave në arsimin profesional, prandaj ata i tërheqin shumë specialistët tanë.

Gjithashtu, dua t'ju përgëzoj edhe për uljen e normës së specialistëve në arsimin profesional, sepse ka të bëjë shumë, por edhe për marrjen e mësuesve të përgjithshëm nga portali, sepse kjo do të thotë cilësi.

Faleminderit

**Enver Roshi** – Faleminderit!

Koment i gjatë dhe pyetje e shkurtër. Komenti mund të ishte më i shkurtër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Dajna Sorensen** – Ishte koment shumë me vend. Për sa u përket nxënësve që e lënë pa mbaruar arsimin e mesëm profesional, kjo është një problematikë që po e shikojmë me shumë vëmendje dhe ne po ndërgjegjësojmë shkollat për të regjistruar dhe dokumentuar një gjë të tillë.

Krahasuar me një vit më parë, gjatë gjithë periudhës 2018 – 2019 e kemi ndjekur sërish, është shumë substanciale, është në nivelin 10%. Pra, çdo vit ka një *drop out* në masën 10%, në disa shkolla më shumë dhe në disa më pak. Megjithatë, nuk jam në gjendje të jap të dhëna, por përqindja e tyre punësohen jashtë Shqipërisë. Unë kam vetëm informacion nëse punësohen ose jo. Por kjo është një gjë që ne do ta shikojmë me metodologjinë e gjurmimit, më të cilën ne ta ndjekim dhe do të bëjmë këtë ndarje.

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Duke ju falënderuar për ardhjen tuaj, për përgjigjet dhe për komentet që dhatë në lidhje me buxhetin e vitit 2020, ju urojmë ditë të mbarë, pra jeni të lirë të vazhdoni, ndërsa ne si komision do të vazhdojmë me agjendën tonë.

Besoj se vërejtjet dhe sugjerimet tona pasqyrohen edhe në buxhetin

Faleminderit!

Ju lutem na prezantoni projektin që kemi me OSBE-në.

**Edlira Bode** – Faleminderit!

Të dashur kolegë, në zbatim të funksionit të kontrollit parlamentar që ne kemi për detyrë, me kryetarin e komisionit kemi biseduar dhe kemi menduar të shfrytëzojmë mundësinë që na jep programi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra është një program i OSBE-së me fonde zvicerane, i cili mbështet parlamentarët për të kryer funksionin e tyre të kontrollit. Ne e kemi diskutuar me kryetarin e komisionit edhe me përfaqësuesit e OSBE-së që të fillojmë një program të tillë, ku të shkojmë nëpër rrethe dhe të monitorojmë zbatimin e politikave apo ligjeve. Propozimi ynë është që ta nisim me monitorimin e zbatimit të *check up-it*, nga Ministria e Shëndetësisë, duke bërë një vizitë në qarkun e Elbasanit dhe të Korçës, pra duke vizituar jo vetëm spitale rajonale, ku kemi shkuar më shpesh, por edhe spitale bashkiake dhe qendra shëndetësore, pra aty ku kryhet kontrolli shëndetësor bazë. Vizita do të jetë 1 ose 2-ditore, kjo varet se si e vendosim ne. Pra propozimi është që të ta fillonim me një vizitë në qarkun e Elbasanit dhe të Korçës, ku mund të përzgjedhim një spital rajonal dhe një qendër shëndetësore dhe pastaj të vazhdojmë me zona të tjera të Shqipërisë, duke e përmbyllur nga muaji prill me një raport drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me gjetjet tona. Nëse jeni dakord, mund t'i drejtohem OSBE-së për mbështetje dhe e realizojmë në dhjetor vizitën e parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E vendosim ne bashkë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është propozim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa të duam ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enver Roshi** – Mondë, një sekondë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë mendoj që Edlira në bashkëpunim me komisionin të bëjë një kërkesë bashkëpunimi OSBE-së me titull: “Vizitë për implementimin e legjislacionit shëndetësor në qarkun e Elbasanit dhe Korçës lidhur me *check up-in*”. Kjo duhet të bëhet brenda dy ditëve. Ata marrin përsipër transportin, fjetjen dhe drekën, pra çdo gjë, ndërsa ne do të bëjmë programin. Të njoftohen edhe institucionet pritëse në Elbasan dhe Korçë. A jeni dakord me këtë?

Miratohet.

Lidhur me projektbuxhetin e paraqitur nga zëvendësministrja dhe ministrja e Financave, a jeni dakord në parim?

Miratohet.

E mbyllim mbledhjen e sotme.

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**

